

Raport vjetor 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
1 Kuadri ligjor mbi barazinë dhe antidiskriminimin	5
1.1 Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit 5	
1.1.1 Instrumentet në kuadrin e OKB-së	5
1.1.2 Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës	8
1.1.3 Standardet e Bashkimit Evropian	10
1.2 Kuadri Ligjor Shqiptar	12
1.3 Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksonimin e KMD	28
1.3.1 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative e tij	28
1.3.2 Zyra e KMD	29
1.3.3 Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ..	29
1.3.4 Kompetencat e Komisionerit	30
2 Mbrojtja nga Diskriminimi dhe Promovimi i Barazisë	31
2.1 Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit	31
2.2 Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	32
2.3 Procedura e shqyrtimit të ankesave	32
2.3.1 Çështjet e trajtuara nga KMD, gjatë vitit 2019	33
2.3.2 Ankesat	33
2.3.3 Ankuesit	34
2.3.4 Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)	36
2.3.5 Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive	36
2.3.6 Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara	37
2.3.7 Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.	38
2.3.8 Vendimet sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat	41
2.3.9 Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve	42
2.3.10 Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara	47
2.4 Proceset Gjyqësore	49
2.4.1 Pjesëmarrja në proceset gjyqësore	49
2.4.2 Vendimmarrja e Gjykatës	51
2.5 Rekomandime të Zyrës së KMD	52
2.5.1 Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore	52

2.6	Ndërgjegjësimi.....	62
2.6.1	Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media	63
2.7	Veprimtaria monitoruese e KMD.....	74
2.7.1	Barazia Gjinore në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor.....	74
2.7.2	Monitorimi i transportit urban për PAK	75
2.7.3	Bashkëpunime.....	76
2.7.4	Pjesëmarrja nëgrupe pune ndërinstitutionale.	80
2.7.5	Programi i transparencës.....	81
3	Zyrat Rajonale	82
3.1	Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër	82
3.2	Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë	93
3.3	Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier.....	100
4	Aspekte të Shërbimeve.....	105
4.1	Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2019	105
4.2	Menaxhimi i burimeve financiare.....	107
4.3	Veprimtaria e IT.....	108

Hyrje

Bazuar në ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

KMD e mbështet veprimtarinë e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Veprimtaria vjetore e KMD është udhëhequr edhe nga Plani Strategjik 2018-2021, i cili përbën një instrument të rëndësishëm, ku përcaktohen vizioni, misioni dhe objektivat strategjikë. Vizioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është:

“Të jetojmë në një shoqëri ku promovohen parimet e barazisë, mundësitë dhe shanset e barabarta”.

Referuar nenit 26, të ligjit Nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, mbi aktivitetet e veprimtarisë institucionale. Raporti përfshin analizë të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përgjithësi, si dhe puna e Komisionerit dhe Zyrës janë reflektuar me qëllim njohjen dhe informimin me veprimtarin konkrete të ushtruar, sipas fushës së kompetencës që mbulon.

KMD ka përgatitur dhe dërgon përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2019”.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Vlerësimet dhe Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2019”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Gjithashtu, Manuali i monitorimit vjetor dhe periodik i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përmes Vendimit Nr. 134/2018, ka shërbyer për hartimin e këtij Raporti Vjetor të KMD, si institucion i pavarur i krijuar me ligj, në kuadër të kontrollit parlamentar.

Kuadri ligjor mbi barazinë dhe antidiskriminimin

1.1 Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

1.1.1 Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument “soft law”, ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave.

DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta...”*. Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër”. Në nenin 7 kemi “të drejtën për barazi përpara ligjit”, ku parashikohet shprehimisht se *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹, parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër”*.

¹ Ligj nr. 7510 date 08.08.1991

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991². Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³ (CRPD) është miratuar në 13 dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012⁴. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010.

KDPAK ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të. Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7 që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵(CEDAW), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993⁶. Ndërsa Protokolli Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2003⁷. Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre,

²Ligj Nr. 7511 date 08.08.1991

³Convention on the Rights of Persons with Disabilities

⁴Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012

⁵Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women

⁶Ligji 1769/ 9.11.1993

⁷Ligj Nr. 9052, date 17.04.2003

pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit “diskriminim ndaj grave” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshpejtimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t’i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t’u siguruar, mundësitë për të përfutur shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸, ka përcaktuar në Preambulën e saj se *“të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”*.

Sipas kësaj Konvente, “diskriminimi racial” nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërroje ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1)

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë

⁸ Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993

së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore. Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5).

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁹, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992¹⁰. Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve pale që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij. Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së “Për Të Drejtat e Fëmijëve”, Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet të Armatosur¹¹ dhe Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë¹².

1.1.2 Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Legjislacioni për trajtimin e barabartë, sipas standardeve të Këshillit të Evropës, duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi, midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë. Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si aksesin në mallra dhe shërbime, strehimin, arsimin, mbrojtja sociale, kujdesin shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi më 3 shtator të vitit 1953.

⁹Convention on the Rights of the Child

¹⁰Ligj datë 27.02.1992

¹¹Ratifikuar me Ligj Nr.9833, datë 22.11.2007

¹²Ratifikuar me Ligj Nr.9834, datë 22.11.2007

¹³KEDNj u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996¹⁴.

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, “ndalimi i diskriminimit”, në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”*. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollin e saj shtesë.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 prill 2005i, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar). Në nenin 1 *“ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”, sanksionohet në mënyrë të shprehur se “Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër” dhe se “Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”*.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar¹⁵, e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999¹⁶, ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t’u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

¹⁴Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

¹⁵Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002

¹⁶Ligji Nr. 8496, date 03.06.1999

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹⁷ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

Rekomandimet e Përgjithshme të Politikave nga Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), të cilat ofrojnë udhëzime të hollësishme për politikë-bërësit, drejtuar qeverive të të gjitha shteteve anëtare, të cilët janë të ftuar ti përdorin kur hartojnë strategji dhe politika kombëtare në fusha të ndryshme.

1.1.3 Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë “barazisë”. Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për *çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionimi politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, mosha ose orientimi seksual*.

¹⁷Ligj Nr. 104 date 11.08.2012 ‘Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyt me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19 i **Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian** (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian... të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin *në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual*. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës” 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të 11 publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe **identiteti gjinor**.

Rekomandimi i Komisionit Evropian¹⁸mbi Standartet e Organeve të Barazisë, synon të përcaktojë masa që Shtetet Anëtare mund të aplikojnë për të ndihmuar në përmirësimin e pavarësisë dhe efektivitetit të organeve të barazisë, veçanërisht në lidhje me aftësinë e tyre për të siguruar që individë dhe grupe personash që janë të diskriminuar mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

1.2 Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe në nenin 18/2 parimi i mosdiskriminimit, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes ligjit nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke sanksionuar, në nenin 134, se “Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”*.

Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përafruar plotësisht

¹⁸22.06.2018

me: Direktivën 2000/43/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”, Direktivën 2000/78/KE për “Përcaktimin e një kuadri të 12 përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”, Direktivën 2004/113/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime” dhe Direktivën 2006/54/KE për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese të shkaqeve të mbrojtura të diskriminimit, duke iu referuar shprehimisht gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo sociale, shtatzënisë, prindërve, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit civil, banimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, paaftësisë, përkatësisë në një grup të caktuar - ose çdo shkak tjetër (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat.

Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një iniciativë e një grupi deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë. Ligji Nr.10221 datë 4/2/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD) është i përafruar me katër direktivat e BE¹⁹ në fushën e mosdiskriminimit. Ligji

¹⁹Direktiva e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.

Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

10221/2010 tashmë ka mbushur 10 vjet nga miratimi i tij. Praktika, elaborimi i termave të rinj gjenerojnë nevojën për disa ndryshime në ligjin aktual.

Nisur nga këto premisa, modifikimet e propozuara prekin pjesë të ndryshme të Ligjit 10221/2010 si në aspektin e tij substancial duke shtuar shkaqe të tjera të diskriminimit dhe formave të diskriminimit, si në aspektin institucional duke rritur më shumë pavarësinë e institucionit të KMD, ashtu edhe në aspektin procedural duke parashikuar procedura më të lehtësuara e të mirë përcaktuara në funksion të një efektiviteti më të mirë në zbatimin e LMD.

Kështu, në lidhje me shkaqet e diskriminimit shtohet shkaqet e shtetësisë, jetesa me HIV/AIDS dhe të paraqitjes/pamjes së jashme apo aparencës. Format e parashikuara të diskriminimit të përfshira në një dispozitë krejtësisht të re synojnë së pari formalizimin e këtyre formave në ligj duke mos e lënë elaborimin e tyre në diskrecionit të KMD. Edhe pse këto forma kanë munguar në LMD, kjo nuk ka penguar institucionin në marrjen e vendimeve të ndryshme duke i dhënë një interpretim më të gjerë dispozitave ligjore nga KMD.

Parashikohet shtimi i disa formave të reja të diskriminimit në një dispozitë të re (neni 3/1 – Format e Diskriminimit), siç është Diskriminimi i Shumëfishtë, Diskriminimi Ndërsektorial, Gjuha e Urrejtjes²⁰, Segregimi, Ngacmimi Seksual; nga ana tjetër janë rikonsideruar në përkufizim disa forma ekzistuese të diskriminimit si Udhëzimi për të Diskriminuar duke hequr kushtin hierarkik dhe Viktimizimi duke e formuluar më mirë si formë.

Propozohet edhe shtimi i një dispozitë tjetër (neni 3/2 – Format më të rënda të diskriminimit) me qëllim parashikimin e atyre rasteve kur sjellja diskriminuese për mënyrën si është kryer, e përsëritur, e vazhdueshme, motivuar nga disa shkaqe dhe ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme kundrejt subjekteve, në mënyrë që të garantohet një mbrojtje më e madhe.

Një dispozitë e shtuar është edhe neni 4/1 – Organizatat me Interesa Legjitime. Synimi i kësaj dispozite është përcaktimi i një roli më aktiv të OSHC në mbrojtjen e të drejtave të njeriut por edhe të një bashkëpunimi me institucionin e KMD.

Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime". Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

²⁰ Meqenëse nuk ka një përkufizim të përcaktuar të Gjuhës së Urrejtjes është marrë në konsideratë përkufizimi i bërë nga ECRI në Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme NR.15.

Në aspektin institucional janë propozuar disa ndryshime si në lidhje me kriteret për t'u zgjedhur Komisioner ashtu edhe në dhënien e më shumë garancive për shkarkimin e tij.

Në lidhje me aspektet procedurale janë parashikuar një serë propozimesh për ndryshime me qëllim zhdervjellsimit dhe qartësimin e procedurave, por edhe një efektivitet më të madh të institucionit të KMD. Në këtë këndvështrim ndryshimet prekin si aspektin e kompetencave, si atë të hetimit administrativ ashtu edhe të vendimeve të KMD-së.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë²¹, ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët²².

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë; b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë; c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën; ç) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga këto organizata.

²¹Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.

²²Ndryshuar me ligjin Nr. 136/2015, datë 5.12.2015

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimi të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërblim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: *“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*; Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se *“Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësive të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar.”* etj.

Kodi Penal²³ ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”*

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin

²³Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; ndryshuar në vitin 2017.

e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor²⁴.

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, *“Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”*.

Kodi i Familjes²⁵. Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesat është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtit seks nuk janë ende të pranuar. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurës Administrative²⁶ parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit *“1.Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë” dhe “3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me mjetet e kërkimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar shprehimisht se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

²⁴Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me ligjin Nr. 144/2013, datë 2.5.2013.

²⁵Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.

²⁶Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare 87/2015

Kodi i Procedurës Civile

Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 5 maj 2017, kanë hyrë në fuqi në nëntor 2017.

KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, në Kreun VI *“Procedurat përpara gjykatës”*, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë.

Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh.

Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”*.

Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’i kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin prima facie - *“në pamje të parë”*²⁷, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

²⁷ Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu ligjin 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i cili ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin nr. 37/2017, datë 30 mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet *“Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi”*, neni 11, i cili parashikon shprehimisht se *“1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërore ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit”, dhe “2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni”*.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç’ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në qershor të vitit 2017.

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1).

Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime: 1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvapura dhe progresive. 2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. 3. **Barazia dhe mosdiskriminimi**. 4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës. 5. Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës. 6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit. 7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj. 8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë. 9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës. 10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. 11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, “parime të përgjithshme”). Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuara (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligj Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”

Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1)

Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2)

Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohej”.

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media.

Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligj “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në nëntor 2017. Sipas objektivit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se: “1. Ndalohej çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare. 2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme: a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës; b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional; c) për të forcuar dialogun ndërkulturor; ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi”.

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Ligj “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Ligji i ri për ndihmën juridike Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: a) viktimave të dhunës në familje; b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal; c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror; d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit; e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore; f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi; g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor; gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale; h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”

Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si *“Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara”*, *“Mohim i përshtatjes së arsyeshme”* apo edhe *“Përshtatje e arsyeshme”* të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, *“monitorimi”*, paragrafi 2, parashikon se: *“Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Ligji 44/2012 “Për shëndetin mendor”

Ligji Nr. 44/2012 *“Për shëndetin mendor”*, sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi *“diskriminim”* përkufizohet në përputhje me ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit *“Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë”*.

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK përsa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përrjashtim bën neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar

Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin ne mbrojtje invalidët, ne mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoz, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2).

Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike. b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) me mjete ndihmëse kardiake etj; - Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 përqind të vlerës së biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar

Bazuar në nenin 1, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1). Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4).

Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar

Ligji Nr. 44/2016 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në përputhje edhe me standartet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPK), si dhe ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”, ka integruar konceptet e “Vlerësimit bio-psiko-social” dhe “Komisionit shumëdisiplinor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar”.*

Ligji ka shtuar si përfitues të shërbimeve shoqërore azilkërkuesit e mitur, të pashoqëruar.

Ligji nr. 44/2016, ka përcaktuar se përfituesve të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 48 muajve punësimi, duke i mbajtur në skemë personat edhe për 24 muaj të tjerë, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm ligjor i futur me ligjin nr. 47/2014, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, i cili parashikonte se “Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi”.*

Gjithashtu, ligji nr. 44/2016 ka parashikuar të drejtën e ankimit edhe në gjykatë. Ligji përcakton se, aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”*

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.(neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* (neni 3, pika 19).

Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj nr. 22/2018 “Për strehimin social”

Ky ligj është miratuar rishtazi në Maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfutur strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.”

Ligj nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikët e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punë, janë përballur me situata diskriminuese.

Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “orientimin seksual”. Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për

Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor parauniversitar²⁸.

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”.

Ligj nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar

Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, parashikon respektimin e të drejtave të njeriut, në nenin 5, ku të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre, të grave të paraburgosura dhe të dënuara, të të miturve të paraburgosur, të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor dhe të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar.

Këto ndryshime kërkojnë parandalimin e çdo akti dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi ndaj grave të paraburgosura dhe të dënuara.

Në përputhje me legjislacionin për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, ky ligj parashikon se, masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për grupe të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim.

Masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin u ofrohen të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të përballjes me forma të ndryshme dhune, para ose gjatë qëndrimit në institucion.

Me këto ndryshime ligjore, trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve orientohet nga rehabilitimi dhe ri-integrimi i individualizuar sipas nevojave. Programe kulturore të veçanta parashikohen të ofrohen për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajve dhe personave pa shtetësi.

²⁸ KMD, Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”

Edhe shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim, për shkak të statusit ligjor të personit në institucion ose për çdo shkak tjetër.

Ligji “Për mediat audiovizive në Shqipëri”

Ligji 97/2013, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të kodit të udhëzimeve etike për transmetimet audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër.*

1.3 Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksonimin e KMD

1.3.1 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative e tij

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15 datë 25 shkurt 2010. Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.


1.3.2 Zyra e KMD

Bazuar në nenin 22 pika 2 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit.

Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri në vitin 2018. Me vendimin nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

1.3.3 Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



1.3.4 Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve. Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE. Në rast se do të kryenim një studim krahasues midis kompetencave të KMD-së, të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe kompetencave të parashikuara në nenin 20 të Direktivës 2006/54/KE, do të arrinim në këtë klasifikim:

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;
- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- parashtrimin e mendimit me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin e investuar në saje të kërkesës së gjykatës që shqyrton çështjen;
- përfaqësimin e ankuesit në organet gjyqësore në çështjet civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Mbrojtja nga Diskriminimi dhe Promovimi i Barazisë

1.4 Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (KMD), asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

- Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
- Përfaqësimi i çështjeve të diskriminimit në gjykatë.

1.5 Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- Të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar
- Të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji
- T`u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues
- Të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

1.6 Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese.

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i KMD).

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, si dhe shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij.

Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t`u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të KMD. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektime apo seanca dëgjimore mes paleve.

Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së ankesës. Nëse gjatë

procedurës administrative është, zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera.


Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

1.6.1 Çështjet e trajtuara nga KMD, gjatë vitit 2019.

Në periudhën nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019, KMD ka trajtuar gjithsej 225 çështje, (215 ankesa dhe 10 çështje ex-officio). Nga këto, 171 çështje (163 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) të regjistruara në vitin 2019, si dhe 54 çështje (52 ankesa dhe 2 çështje ex-officio) të mbartura nga viti 2018.




Grafiku 1. Çështje të trajtuara në vitin 2019

Grafiku 2. Çështje të regjistruara në vitin 2019

1.6.2 Ankesat

Gjatë vitit 2019 pranë Drejtorisë së Pritjes së Ankesave janë regjistruar për t'u shqyrtuar 163 ankesa ndër të cilat:

- 41 (dyzet e një) janë paraqitur pranë DPA-së.
- 70 (shtatëdhjetë) kanë ardhur me postë.
- 28 (njëzet e tetë) kanë ardhur nga info@kmd.al
- 24 (njëzet e katër) nga zyrat rajonale, konkretisht:
 - 5 (pesë) Zyra Rajonale Shkodër
 - 14 (katërmëdhjetë) Zyra Rajonale Korçë
 - 5 (pesë) Zyra Rajonale Fier



Grafiku 3. Ankesat e regjistruara gjatë gjashtëmujorit të I-rë të vitit 2019, sipas mënyrës së paraqitjes pranë KMD-së

Numri i ankesave të cilat nuk janë regjistruar si të tilla, është 13 (trembëdhjetë), për shkak se ankuesit nuk i janë përgjigjur kërkesave për plotësim dokumentacioni.


Pranë Drejtorisë së Pritjes së Ankesave janë bërë mesatarisht 600 (gjashtëqind) telefonata gjatë vitit 2019.

1.6.3 Ankuesit


Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime. Nga 225 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2019, për 215 çështje ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në 186 raste ankesat janë paraqitur nga individë (144 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2019 dhe 42 ankesa të mbartura nga 2018), në 16 raste, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (10 ankesa të regjistruara në vitin 2019 dhe 6 ankesa të mbartura nga 2018),

në 13 raste ankesat janë paraqitur nga grup personash (9 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2019 dhe 4 ankesa të mbartura nga 2018).

7 raste ankesat janë paraqitur nga grup personash (4 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2019 dhe 3 ankesa të mbartura nga 2018).



Grafikët 4 dhe 5. Ankesat e regjistruara dhe të mbartura sipas subjekteve ankuese gjatë vitit 2019



Grafiku 6. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2019

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2019 përveç ankesave individuale, janë depozituar edhe 16 ankesa nga organizata me interes legjitim (6 ankesa të mbartura dhe 10 ankesa të regjistruara në vitin 2019). Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e fëmijëve, komunitetit Rom/Egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, etj. Në çështjet e mbartura nga viti 2018 dhe të trajtuara gjatë vitit 2019, 10 ankues janë mbështetur nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2019, në 19 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë. Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe media ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen kryesisht të çështjeve.


1.6.4 Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, gjatë vitit 2019, ka trajtuar gjithësej 10 çështje ex-officio, nga të cilat 2 çështje janë të mbartura nga viti 2018.

Gjatë vitit 2019, KMD ka iniciuar kryesisht hetimin administrativ për 8 raste, pas marrjes së informacionit të besueshëm. 4 (katër) çështje ex-officio janë shqyrtuar nga KMD, në bazë të informacionit të marrë nga media dhe 3 (tre) të tjera janë trajtuar mbështetur në informacionin e përcjellë nga OJF-të. Ndërkohë që, 1 (një) çështje është iniciuar, mbështetur në problematika të evidentuara nga vetë Komisioneri.

1.6.5 Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2019 ka patur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimi, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Fier, Korçë, Shkodër, Elbasan, Mallakastër, Durrës, etj.




Grafiku 7. Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2019, sipas Bashkive

1.6.6 Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Në Zyrën e KMD-së, gjatë vitit 2019, janë paraqitur ankesa për shkaqet e parashikuara në ligj, por ka patur dhe ankesa, në të cilat subjektet nuk ishin në gjendje të identifikonin shkaqet. Mbështetur në KMD, është parashikuar një listë të hapur dhe jo shtrënguese shkaqesh, duke përfshirë dhe rastet për “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh këtu shkaqe, që lidhen me cilësi apo karakteristika individuale të personave apo të një grupi të veçantë personash. Gjithashtu, theksohet se gjatë vitit 2019, janë depozituar ankesa, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2019, të ndara sipas shkaqeve:




Grafiku 8. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2019

1.6.7 Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.

Dispozitat e ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (KMD) parashikojnë 3 (tre) fusha të mëdha veprimi, që gëzojnë mbrojtje, të cilat janë: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve.

Gjatë vitit 2019, pranë zyrës së Komisionerit janë trajtuar gjithsej 225 çështje, (215 ankesa dhe 10 çështje ex-officio). Nga këto, 171 çështje (163 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) janë të regjistruara në vitin 2019.




Grafiku 9 dhe 10. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2019, të ndara sipas fushave.

1.6.7.1 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Numri i ankesave të regjistruara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për vitin 2019, ka qenë 62 të tilla, ndërkohë që numri i ankesave të trajtuara, në këtë fushë duke përfshirë këtu edhe ankesat e mbartuar nga viti 2018, ka qenë 85 ankesa, nga të cilat, 71 ankesa drejtohen kundër subjekteve publike dhe 18 ankesa drejtohen kundër subjekteve private²⁹.

Nga 71 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 32 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 39 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.

Ankesat e paraqitura në këtë fushë, kanë të bëjnë kryesisht me mos dhënien e shërbimeve të nevojshme nga njësitë e qeverisjes vendore ndaj individëve të ndryshëm, që u përkasin komuniteteve të ndryshme apo shtresave vunerabël.




Grafiku 11. Fusha e të mirave dhe shërbimeve

²⁹Numri i subjekteve është më i madh sesa numri i ankesave, pasi një ankesë drejtohet kundër 1 ose më shumë subjekteve publike ose private.

Një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe ndaj institucioneve të administratës qendrore, ku objekti i ankesave konstotn në mosofrimin apo garantimin e një serie shërbimesh si shërbimi shëndetësor dhe mjekimi me medikamentet e nevojshme etj. Shkaqet kryesore, për të cilat janë paraqitur ankesat në fushën e shërbimeve kanë qënë: raca, gjendja ekonomike dhe aftësia e kufizuar.

1.6.7.2 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Ankesat e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të bëra kundër institucioneve Publike, po ashtu dhe kundër subjekteve private. Objekti i ankesave të trajtuara në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura në marrëdhëniet e punës, të tilla si aksesit në punësim dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës. Numri i përgjithshëm i ankesave, në fushën e punësimit, që janë trajtuar gjatë vitit 2019, është 120, nga të cilat 30 ankesa/çështje ex-officio janë të mbartura nga viti 2018 dhe 90 ankesa/çështje ex-officio të regjistruara në vitin 2019. Nga të gjithë ankesat e trajtuara, 80 ankesa/çështje ex-officio drejtohen kundër subjekteve publike dhe 40 të tilla kundër subjekteve private.



Grafiku 12. Fusha e punësimit

Nga 80 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 39 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 41 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Ankesat e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar, etj.

1.6.7.3 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Gjatë vitit 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 20 çështje, në fushën e arsimit, nga të cilat 1 çështje është e mbartur nga viti 2018 dhe 19 çështje janë të regjistruara gjatë vitit 2019. Në të gjitha çështjet e trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike (21 të tilla, pasi një ankesë është drejtuar kundër 2 subjekteve publike), ndër të cilat në 7 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të arsimit qendror dhe në 14 raste kundër institucioneve të arsimit vendor.

Objekti i ankesave të paraqitura në fushën e arsimit ka qënë përjashtimi i komuniteteve në nevojë nga tarifat e regjistrimit në shkolla dhe kopshte, fenomeni i segregimit të nxënësve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare, caktimi i mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, aksesit i fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat me arsim të orientuar, fenomeni i bullizmit në shkolla etj. Shkaktohet kryesore të pretenduara në ankesa janë aftësia e kufizuar, raca etj.

1.6.7.4 Ankesat e trajtuara dhe vendimet e dhëna, me objekt mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar për shkak të detyrës, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Në këtë kuadër, por edhe në përmbushje të detyrimeve të marra përsipër në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020³⁰, për të pasqyruar në raportet e institucionit, të dhëna dhe informacione të posaçme lidhur me çështjet e diskriminimit të fëmijëve, sa më poshtë jepet një informacion në lidhje me ankesat e trajtuara dhe vendimet e dhëna për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 25 çështje (22 ankesa dhe 3 çështje ex-officio) që kanë patur në fokus, problematika të lidhura me fëmijët.

Për sa më sipër, KMD është shprehur me 17 vendime mbi çështjet e përfunduara, që klasifikohen si më poshtë:

- 7 vendime diskriminimi;
- 5 vendime mosdiskriminim;
- 3 vendime pushim shqyrtimi si pasoje e tërheqjes së ankesës nga ankuesi;
- 1 vendim mospranimi.
- 1 vendim pushimi pasi është arritur efektiviteti

Objekti i ankesave me subjekt fëmijët, konsiston kryesisht në problematika, që lidhen me caktimin e mësuesve ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor dhe atë shkollor, segregimin e nxënësve Rom/Egjiptian në fushën e arsimit, ofrimi i shërbimeve për fëmijët Rom/Egjiptian në qendra komunitare, regjistrimin në arsimin parashkollor (në kopshte) pa pagesë, duke u miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë përjashtimi nga tarifa e regjistrimit për fëmijët që vijnë nga familje të komunitetit Rom/Egjiptian, marrja e fëmijëve nga qendrat rezidenciale dhe fuqizimi ekonomik i familjeve, etj.

³⁰ Miratuar me VKM nr 372, datë 26.04.2017 "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020"

1.6.8 Vendimet³¹ sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej **73 vendime**, nga të cilat, 24 vendime për çështjet e mbartura nga viti 2018 dhe 49 vendime për çështjet e regjistruara në vitin 2019. Nga 73 vendime, 63 vendime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 10 vendime janë dhënë kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 22 raste, ndër të cilat 21 vendime kundër subjekteve publike dhe 1 vendim kundër një subjekti privat. KMD është shprehur gjithashtu me 17 vendime mosdiskriminimi, 18 vendime për mospranim të ankesës, 8 vendime për pushim të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, 3 vendime për pushim të shqyrtimit të çështjes, si pasojë e tërheqjes së ankesës nga ankuesi, 3 vendime për pushimin e shqyrtimit të çështjes për mungesë provash, dhe 4 vendime me gjobë³² për mosdhënie të informacionit të kërkuar nga KMD.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej **90 vendime**, nga të cilat, 63 kundër subjekteve publike dhe 27 kundër subjekteve private.

Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **30 raste**, ku në **23 raste** kundër subjekteve publike dhe **7 raste** kundër subjekteve private. Në vendimet ku është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka kërkuar nga subjektet përkatëse, rregullimin e situatave diskriminuese, si dhe rikthimin në punë të individit të diskriminuar.

Komisioneri është shprehur me mosdiskriminim në **32 raste**, në **21 raste** është shprehur për mospranimin e ankesës, **1 vendim** për pushim të shqyrtimit të çështjes, si pasojë e tërheqjes së ankesës nga ankuesi, **3 raste** është pushuar shqyrtimi i çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, si dhe për **3 raste** është dhënë vendim për pushimin e shqyrtimit të çështjes si pasojë e gjykimit të çështjes me objekt diskriminimi në gjykatë.

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej **10 vendime**, të cilat, janë të gjitha të drejtuara kundër subjekteve publike. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 3 raste. Komisioneri është shprehur me 2 vendime mosdiskriminimi, 1 vendim mospranimi, 2 vendime pushim shqyrtimi si pasojë e tërheqjes së ankuesit, 2 vendime pushim shqyrtimi pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

³¹Në këto vendime janë përfshirë edhe 3 vendime me gjobë për mosdhënie informacioni (të pashfuqizuara).

³²(1) Komisioneri është shprehur me 2 vendimarrje brenda të të njëjtit vendim, përkatësisht me (a) pamundësi shqyrtimi për mungesë provash dhe (b) me gjobë për mosdhënie informacioni. Në këtë kontekst, ky do të llogaritet si 1 vendim i vetëm, pavarësisht se në statistika të dy vendimarrjet e KMD-së janë shënuar si të veçanta. (2) Një vendim me gjobë për mosdhënie informacioni drejtuar ndaj 10 subjekteve është shfuqizuar, pasi subjektet kanë dërguar informacionin e kërkuar nga KMD, brenda afatit 7 ditor. Ky vendim është shënuar si e dhënë statistikore, por nuk rezulton i llogaritur në numrin e përgjithshëm të vendimeve, pasi është i shfuqizuar.

1.6.9 Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve³³


1.6.9.1 Vendimet e çështjeve me shkak racën³⁴

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 33 vendime themeli dhe 4 vendime gjobe për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 13 vendime diskriminimi;
- 10 vendime mosdiskriminimi;
- 3 vendime mospranimi;
- 4 vendime pushimi pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime pushim shqyrtimi të ankesave, pasi ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore;
- në 1 vendim pushim shqyrtimi të ankesës pasi është bërë i pamundur sigurimi i provave për të marrë një vendim përfundimtar;
- 4 vendime me gjobë, për moszbatim të vendimit.

Vihet re se, vazhdon të jetë i pranishëm diskriminimi i strukturuar që nuk i referohet një individi, por të gjithë grupit ose komunitetit.

Gjithashtu, evidentohet një shtim i numrit të çështjeve, në të cilat ankuesit pretendojnë diskriminim për më shumë se një shkak, si dhe konstatime të diskriminimit në formë të shumëfishtë, pra për më shumë se një shkak, nga ana e subjekteve të ndryshme.



Grafiku 13. Vendimet e vitit 2019 me shkak racën

³³ Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me vendime mbi ankesat e qytetarëve, ku pretendohet diskriminim për një ose më shumë shkaqe të përcaktuara në nenin 1, të KMD. Në këtë kontekst, Komisioneri shprehet në të njëjtin vendim për 2 ose më shumë shkaqe diskriminimi, të pretenduara nga ankuesit në ankesat respektive. Për këtë arsye, numri total i vendimeve të miratuara nga KMD, nuk mund të përputhet me numrin e vendimeve të dhëna sipas shkaqeve.

³⁴Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 "Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".

1.6.9.2 Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 20 vendime themeli dhe 3 vendime gjobe për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 9 vendime diskriminimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi;
- 2 vendim mospranimi;
- 2 vendime pushimi pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendime pushim shqyrtimi të ankesave, pasi ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore;
- 3 vendime me gjobë, për moszbatim të vendimit.

Ankesat me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar kanë konsistuar kryesisht në problematikat e mëposhtëme:

- Mos garantimi i trajtimit të pacientëve hemofilikë, me aftësi të kufizuar, me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor, si dhe mosofrimi i ndihmës mjekësore për ta në spitalet rajonale.
- Mos garantimi i aksesueshmërisë fizike në zyrat e Aleat shpk, ku individët me aftësi të kufizuara, aplikojnë dhe riaplikojnë për dokumentet identifikuese;
- Mos siguri i transportit urban qytetas dhe ndërqytetas falas për kategorinë e individëve me aftësi të kufizuara (paraplegjikeve dhe tetraplegjikeve dhe invalidët e punës) nga organet e pushtetit lokal dhe atij qendror;
- Ngritja e një institucioni të përshtatshëm për të gjithë personat që i përkasin kategorisë të sëmurëve të shëndetit mendor, të cilët janë të akomoduar në sistemin e IEVP-ve.
- Përshtatja dhe funksionimi i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të organeve të pushtetit lokal, për personat me aftësi të kufizuara, lidhur me restaurimin e rampës dhe ristampimin e logove të vendparkimeve të personave me aftësi të kufizuar në godinat përkatse.
- Vendosja e mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parashkollor, 9 vjeçar dhe të mesëm.
- Punësimi i shtetasve me aftësi të kufizuara.
- Aksesimi në shkollat me arsim të orientuar, për fëmijët me aftësi të kufizuara etj;

1.6.9.3 Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 45 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 15 vendime diskriminimi;
- 18 vendime mosdiskriminimi;
- 11 vendime mospranimi;
- 1 vendim pushimi për pamundësi për të siguruar provat;

Ankesat me pretendim diskriminimin për shkak të bindjes politike kanë konsistuar kryesisht problematika që lidhen me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak.

1.6.9.4 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Komisioneri është shprehur me 15 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio gjatë vitit 2019, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime mospranimi;
- 3 vendime pushimi pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime pushim shqyrtimi të ankesave, pasi ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore.

1.6.9.5 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 18 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 5 vendime diskriminimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi;
- 5 vendime mospranimi;
- 2 vendime pushim shqyrtimi të ankesave, pasi ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore.

1.6.9.6 *Vendimet e çështjeve me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor*

Komisioneri është shprehur me 12 vendime themeli gjatë vitit 2019, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 6 vendime diskriminimi;
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 1 vendim mospranimi;
- 2 vendime pushimi pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendime pushimi për pamundësi për të siguruar provat.

1.6.9.7 *Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.*

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 12 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 5 vendime diskriminimi;
- 1 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendim mospranimi.

1.6.9.8 *Vendimet e çështjeve me shkak moshën.*

Komisioneri gjatë vitit 2019, është shprehur me 7 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të moshës dhe 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 2 vendim mospranimi;
- 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi.

1.6.9.9 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjes shoqërore.

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 9 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore dhe 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi;
- 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi

1.6.9.10 Vendimet e çështjeve me shkak vendbanimit.

Komisioneri është shprehur me 2 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio gjatë vitit 2019, ku është pretenduar diskriminim për shkak të vendbanimit, si dhe 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet, si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi;
- 1 vendim me gjobë për moszbatim vendimi.

1.6.9.11 Vendimet e çështjeve me shkak përgjegjësia prindërore.

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 2 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të përgjegjësisë prindërore. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet, si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi;
- 1 vendim mosdiskriminimi.

1 vendim me gjobë për moszbatim vendimi

1.6.9.12 Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.

Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 2 vendime themeli mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime mosdiskriminimi.

1.6.10 Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, fillimisht ankesat i janë nënshtruar një shqyrtimi paraprak, lidhur me kushtet e pranimit. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka patur mungesë të informacionit, që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që të plotësojë kriteret e kërkuara nga KMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Fierit dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2019, është shprehur me 171 vendime themeli, ndër të cilat 53 vendime për ankesa/çështje ex-officio të mbartura nga viti 2018 dhe 118 vendime³⁵, për ankesa të depozituara apo çështje ex-officio të iniciuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2019.

Vendimet e dhëna nga KMD, klasifikohen si më poshtë:

- 55 vendime konstatim diskriminimi;
- 51 vendime konstatim mosdiskriminimi;
- 40 vendime për mospranim të ankesës;
- 13 vendime për pushimin e çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave;
- 3 vendim për pushimin e çështjes, (për shkak se ankesat po shqyrtohen në Gjykatë),
- 3 vendime pushimi për shkak të pamundësisë për të siguruar provat për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës;
- 6 vendime pushimi për shkak se ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2019, Komisioneri është shprehur me vendime gjobe, si vijojnë:

- 10 vendime me gjobë për moszbatim të vendimeve në themel të Komisionerit;
- 4 vendim gjobë³⁶ kundër subjekteve, që nuk kanë dhënë informacion, pas kërkesës zyrtare të KMD-së. Një prej këtyre vendimeve është shfuqizuar, pasi është zbatuar nga subjektet respektive, brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në


³⁵Këtu nuk përfshihet vendimi me gjobë për mosdhënie informacioni nga subjekti përkatës;

³⁶**Sqarim:** (1) Një vendim me gjobë është dhënë ndaj 10 subjekteve. Në vijim, ky vendim është shfuqizuar, pasi subjektet përkatëse kanë dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

(2) Në një vendim themeli, Komisioneri është shprehur me 2 vendimarrje: **(1) pushim shqyrtimi për pamundësi provash dhe (2) gjobë për mosdhënie informacioni ndaj subjektit përkatës.** Pavarësisht se në statistikën e mësipërme, 2 vendimarrjet janë nxjerrë në mënyrë të veçantë, në llogaritjen e numrit total të vendimeve, ky do të llogaritet si një vendim i vetëm.

vendim. Ndërkohë që, një tjetër vendimmarrje gjobe për mosdhënie informacioni, është marrë në të njëjtin vendim, nëpërmjet së cilit KMD është shprehur për pushim të çështjes për pamundësi provash, i cili është raportuar më lart.

Në total, numri i vendimeve të Komisionerit për vitin 2019, është 183 vendime.



Grafiku 14. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2019

Për sa më sipër, vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2019, në 11 raste subjektet kanë zbatuar masat e vendosura nga KMD për rregullimin e situatës diskriminuese.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka dërguar 534 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të ankesave, ka zhvilluar 24 inspektive dhe 65 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Nga 55 ankesa/çështje ex-officio, për të cilat, KMD është shprehur me vendime diskriminimi përgjatë vitit 2019, për 34 prej tyre janë zhvilluar seanca dëgjimore, fakt që dëshmon mbi rëndësinë e zhvillimit të seancave të tilla, për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, përgjatë kryerjes së hetimit administrativ.

Veprimtaria e zhvilluar në kuadër të shqyrtimit të ankesave:

- 534 shkresa, kërkesë për informacion dërguar subjekteve;
- Janë organizuar 24 inspektive;
- Janë zhvilluar 65 seanca dëgjimore publike.

Referuar vendimeve të dhëna nga Komisioneri konstatohet se gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2019, janë dhënë 52 vendime me konstatim diskriminimi të drejtpërdrejtë dhe 3 vendime me konstatim të tërthortë.

Referuar subjekteve ankues, rezulton se subjekti ankues ka qenë femër në 20 vendime diskriminimi, në 25 vendime diskriminimi subjekti ankues ka qenë mashkull, në 1 vendim subjekti ankues ka qenë OJF, në 9 vendime diskriminimi subjekti ka qenë grup personash/komunitete.

Vlen të theksohet fakti se KMD gjatë vendimeve të dhëna me diskriminimin përgjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2019, ka konstatuar në 9 raste diskriminimin e ankuesve për më shumë se një shkak (Diskriminimi i shumëfishtë).

Gjuha e urrejtjes

Gjatë vitit 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 14 raste (12 ankesa dhe 2 ex-officio), të cilat si shkak kanë patur kryesisht përkatësinë në komunitetin LGBT dhe gjuhën e urrejtjes ndaj këtij komuniteti, sikurse edhe gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit rom dhe egjiptian.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të sipërpërmendura, në 3 raste, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e subjekteve ankuese. Lidhur me rastet ku është konstatuar diskriminim, 2 prej tyre janë ende në proces plotësimi të masave rregulluese të vendosura nga KMD dhe 1 vendim është kundërshtuar në gjykatë.

Në 4 raste është konstatuar mosdiskriminim, në 1 rast ankesa nuk është pranuar, në 1 rast është pushuar çështja, për shkak se është braktisur nga subjekti ankues, në 2 rast është pushuar shqyrtimi i ankesës për shkak se është arritur efektiviteti pasi subjektet ndaj të cilëve ishte nisur procedura hetimore kanë kërkuar falje publike për shprehjet e përdorura dhe 3 ankesa janë ende në proces shqyrtimi.

1.7 Proceset Gjyqësore


1.7.1 Pjesëmarrja në proceset gjyqësore

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” e vendos KMD në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përsa i takon pjesëmarrjes së institucionit në proceset gjyqësore. Vendimet e dhëna nga KMD janë të ankimueshme në gjykatë. Komisionerit i është dhënë kompetenca të përfaqësojë subjektet që pretendojnë se janë viktimat të sjelljeve diskriminuese në gjykatë³⁷. Gjithashtu, ligji parashikon detyrimin e gjykatës për ta njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo

³⁷Neni 34, pika 3 e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se “Një organizatë me interes të ligjshëm ose Komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që Komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurorë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi”.

padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t'i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika 1/gj).


Gjatë vitit 2019, KMD ka marrë pjesë në 86 (tetëdhjetë e gjashtë) procese gjyqësore, në raport me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) procese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2018. Rritja e numrit të proceseve gjyqësore në vite tregon se zbatimi i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është rritur dhe tashmë ky ligj është kthyer në një mjet juridik të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave.



Grafiku 15. Proceset gjyqësore

Duke mbajtur në konsideratë që ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” e vendos KMD në një raport të gjerë me gjykatën, roli i KMD në proceset gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2019 në raport me vitin 2018, paraqitet si më poshtë:

- Palë e paditur në 52 (pesëdhjetë e dy) procese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi apo pavlefshmëria e vendimeve të KMD-së, pra kur subjektet e gjetur në shkelje të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” me vendim të KMD, në raport me 33 (tridhjetë e tre) procese gjyqësore për vitin 2018.
- Person i interesuar/palë e tretë në 31 (tridhjetë e një) procese gjyqësore, ku KMD është thirrur në gjykim nga gjykata kompetente, në çështje ku kërkohet dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë, në raport me 27 (njëzetë e shtatë) procese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2018.
- KMD ka kërkuar lëshimin e 3 (tre) Urdhrave të Ekzekutimit nga gjykata. Në përputhje me parashikimet ligjore, KMD i është drejtuar gjykatës me kërkesa për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit, për vendimet me gjobë të KMD në 3 raste, në raport me 6 (gjashtë) raste gjatë vitit 2018.



Grafiku 16. Roli i KMD-së në proceset gjyqësore

1.7.2 Vendimmarrja e Gjykatës

Në vitin 2019, Gjykatat kompetente kanë dalë me 54 vendime për çështje ku KMD ka qenë palë, nga të cilat 36 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë (civile dhe administrative) dhe 18 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e apelit (civile dhe administrative).

Në 36 vendimet gjyqësore, të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë, KMD ka qenë:

- 27 raste palë e paditur
- 9 raste palë e tretë

Në 27 çështjet ku KMD ka qenë palë e paditur në proces, gjykata ka marrë:

- 26 vendime për rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimet e KMD,
- 1 çështje është pranuar padia duke e rrëzuar vendimin e Komisionerit.

Në 9 çështjet ku KMD ka qenë palë e tretë në proces, në paditë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka marrë vendimet si më poshtë:

- 6 vendime për pranimin e padisë, duke konstatuar diskriminimin dhe njohur dëmshpërblimin për diskriminim, nga të cilat në 1 (një) rast KMD ka shqyrtuar administrativisht çështjen duke konstatuar diskriminimin e ankuesit
- 3 vendime për rrëzimin e padisë.

Në 18 vendimet gjyqësore të dhëna nga Gjykatat e Apelit, KMD ka qenë:

- 8 raste palë e paditur
- 10 raste palë e tretë

Në 6 çështjet ku KMD ka qenë palë e paditur në proces, gjykata ka konfirmuar vendimin e KMD, duke vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve.

Në 10 çështjet ku KMD ka qenë palë e tretë në proces, në paditë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka marrë vendimet si më poshtë:

- 6 vendim për pranimin e padisë, duke konstatuar diskriminimin dhe njohur dëmshpërblimin për diskriminim
- 2 vendime për rrëzimin e padisë
- 2 vendim për kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë.

Në çështjet ku KMD ka kërkuar lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga gjykata, kjo e fundit ka dhënë 3 vendime për pranimin e kërkesës dhe lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit.

Gjatë periudhës së raportimit, KMD ka vijuar ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve me gjobë, përmes përmbarimit publik, për 3 (tre) çështje të reja dhe janë ekzekutuar nga shërbimi përmbarimor 3 (tre) vendime me gjobë të KMD-së.

1.8 Rekomandime të Zyrës së KMD

1.8.1 Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore

Në zbatim të kompetencës ligjore të parashikuara nga neni 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, gjatë vitit 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kadhënë rekomandimet e mëposhtme për autoritetet përgjegjëse.

1.8.1.1 Rekomandime për projektligjin “Për nxitjen e punësimit”.

KMD ka dërguar rekomandime Kuvendit mbi Projektligjin “Për nxitjen e punësimit”, Propozimet e dërguara konsistojnë në këto drejtime kryesore:

- Vlerësimin në mënyrë të kujdesshme të të drejtës së personave të huaj apo pa shtetësi, të cilët kanë paraqitur aplikimin për azil, në mënyrë që ata të mos përballen me përjashtim nga shërbimet e ofruara sipas këtij ligji, në kundërshtim me standartet evropiane të trajtimit azilantëve dhe refugjatëve, në mënyrë të posaçme me Direktivën e Këshillit 2003/9/KE, datë 27 janar 2003 “Për përcaktimin e standardeve minimale për pritjen e azilkërkuesve”, e rishikuar (me të cilën rezulton se ligji nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” të jetë përafruar pjesërisht).
- Edhe pse projektligji kishte ruajtur trajtimin me kuota në punësim për personat me aftësi të kufizuara, parashikimet e këtij neni paraqesnin problematika në dy drejtime. Së pari, ishte dyfishuar numri i përgjithshëm i të punësuarve që një punëdhënës duhet të ketë, në mënyrë që këtij të fundit t’i lindë detyrimi për të punësuar një person me aftësi të kufizuara³⁸ dhe së dyti, kishte vendosur një përgjysmim të vlerës që duhet të paguajë një punëdhënës në rast se nuk përmbush detyrimin për të punësuar një person me aftësi të kufizuara³⁹. Masat e propozuara

³⁸Ligji nr. 799/199, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar: “Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 2 punonjës të personelit të tij.

Projektligji i propozuar, “Për nxitjen e punësimit”, parashikonte: “Çdo punëdhënës, i cili punëson më shumë se 49 punonjës, duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 0 punonjës të personelit të tij”.

³⁹Ligji nr. 799/199, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar parashikon: “Një punëdhënës që nuk punëson numrin e rekomanduar të personave me aftësi të kufizuara siç tregohet në nenin 1, është i detyruar të paguajë në një llogari të veçantë në Fondin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit shumën e barabartë me minimumin e pagës, për çdo muaj dhe person me aftësi të kufizuara që ai duhej ta kishte punësuar, por që nuk ka vepruar kështu”.

Projektligji i propozuar, “Për nxitjen e punësimit”, parashikonte: “Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të

nga ky projektligj, nuk janë efektive për arritjen e qëllimit që ky projektligj ka, dhe që është nxitja e punësimit. Rritja e numrit të të punësuarve që një punëdhënës duhet të ketë, nga 2 në 0, ul mundësitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Të njëjtin efekt ka edhe përgjysmimi i detyrimit që duhet të paguajë një punëdhënës, në rast se nuk respekton detyrimin për të punësuar një person me aftësi të kufizuara sipas parashikimeve ligjore, nga 1 pagë minimale që ishte sipas ligjit në fuqi, në 0% të pagës minimale, sepse punëdhënësi paguan më lehtësisht detyrimin e vendosur, se sa punësimin e personit me aftësi të kufizuara. Të gjitha parashikimet ligjore për personat me aftësi të kufizuara shoqërohen në zbatimin e tyre me paragjykimet dhe mendimin që shoqëria ka për personat me aftësi të kufizuara. Akoma në mënyrë të gabuar aftësia e kufizuara, përkthehet shpesh në shoqëri si paaftësi. Por, ajo që duhet të udhëheqë çdo nismë ligjore apo politike shtetërore që prek të drejtat e personave me aftësi të kufizuar është se, barrierat nuk duhen parë tek personi me aftësi të kufizuar, por tek kufizimet që shoqëria ngre duke penguar gëzimin e të drejtave në baza të barabarta me të tjerët. Kuotat në punësim për personat me aftësi të kufizuara, janë masa të përkohshme, që synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe nuk përbëjnë diskriminim. Përkundrazi, dështimi për të marrë masa pozitive, që do të eliminonin pabarazinë dhe diskriminimin, do të mbante në fuqi një situatë eksistuese diskriminuese. Por, masat pozitive, edhe pse të parashikuara nga aktet e ndryshme ligjore, duhet të jenë efektive në mënyrë që të sjellin efektin e dëshiruar, pra përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë. Kuotat në punësim për personat me aftësi të kufizuara, sipas propozimeve të projektligjit, nuk ishin të tilla. Aktet shoqërueses të projektligjit nuk paraqesin asnjë argument të bazuar që do të përlligjte efektivitetin e tyre. Për këto arsye, Komisioneri rekomandoi që kuotat në punësim për personat me aftësi të kufizuara dhe detyrimi për mosrespektimin e tyre, të ruhej sipas parashikimeve të ligjit nr. 799/199, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar⁴⁰.

- Projektligj duhet të pasqyrojë qartë faktin që, të drejtat apo detyrimet sipas këtij ligji zbatohen si për punëdhënësin privat ashtu edhe për punëdhënësin publik. Ky rekomandim u bë pasi, parashikimet në projektligj nuk ishin të qarta nëse detyrimi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara shtrihet njëkohësisht si për punëdhënësin privat ashtu edhe për punëdhënësin publik. Mungesa e qartësisë në lidhje me sa më sipër, mund të shkaktojë zbatim të gabuar të ligjit.

Fondit Social të Punësimit, në masën e 0% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij neni.”.

⁴⁰ Detyrimin për punësimin e 1 personi me aftësi të kufizuar për çdo 2 punonjës dhe detyrimin për të paguar 1 pagë minimale për mospërmbylljen e këtij detyrimi.

1.8.1.2 Rekomandim për kujdestarë të personave me aftësi të kufizuar

-  **Rekomandim për përmirësimin e kuadrit ligjor, me qëllim përfitim në baza të barabarta dhe pa diskriminim bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar, të kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuar.**

KMD ka dërguar rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale duke rekomanduar:

- Marrjen e masave për plotësimin e legjislacionit, me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuar, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor, në baza të barabarta për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.

-  **Rekomandim mbi rishikimin/plotësimin e legjislacionit që lidhet me lehtësirat në transport dhe përfitimin në baza të barabartë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.**

KMD ka dërguar rekomandim për Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, si dhe për dijeni Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale, duke rekomanduar:

- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të kompetencës, për plotësimin e legjislacionit, me qëllim bërjen të mundur që kategoritë e personave me aftësi të kufizuar që i'u është kufizuar aftësia si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin dhe që nuk gëzojnë statusin e personit të verbër, paraplegjikë/tetraplegjikë dhe invalid pune, të marrin të njëjtat përfitime dhe lehtësira në transport, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.
- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të kompetencës, për plotësimin e legjislacionit, me qëllim bërjen të mundur që të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, të marrin të njëjtat përfitime dhe lehtësira në transport, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.
- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të

kompetencës, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar) dhe nenit 11, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, (i ndryshuar).

- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për nxjerrjen e aktit nënligjore, në zbatim të nenit 8, të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për të plotësuar boshllëkun ligjor që ekziston në lidhje me fondet për kompesimin e tarifës së transportit rrethqytetës dhe ndërqytetës. Neni 8, i ligjit nr. 8308/1998, ka parashikime vetëm për fondet për kompesimin e tarifës së transportit qytetas.
- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për të rregulluar mënyrën e përcaktimit të çmimit të biletave për transportin ndërqytetas, për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport (duke përfshirë këtu të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara).
- Organet e pushtetit vendor të ushtrojnë kompetencat e tyre për të përcaktuar fondin e kompensimit për kategoritë e personave që përfitojnë lehtësira në transport, për transportin qytetas dhe rrethqytetas, në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.
- Në çdo nismë të ndërmarrë, është e rëndësishme që termat e aftësisë së kufizuar të jenë në harmoni me standartet e Konventës Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Për të gjitha çështjet që prekin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duhet të ndiqet në mënyrë efektive qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t’i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete.

1.8.1.3 Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”.

KMD ka marrë pjesë në takimin e parë konsultativ të organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për diskutimin e 7 akteve nënligjore, si më poshtë:

- Projekt Vendimi “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional”.

- Projekt Vendim “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.
- Projekt Vendim “Për procedurën e kthimit në fond banese me qëllim strehimi të objekteve pronë shtetërore që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkuruese nga buxheti i shtetit”.
- Projekt Vendim “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkuruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.
- Projekt Vendim “Rregullat e administrimit të kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë ose uzufruktit dhe për bashkëpunimin e tyre me Ministrinë përgjegjëse për strehimin”.
- Projekt Vendim “Për procedurat, kriteret, përparësitë për akordimin e grantit në të menjëhershëm për banesa me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”.
- Projekt Vendim “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e përlllogaritjes së subvencionit”.
- Projekt vendim “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”.

1.8.1.4 Rekomandime për paketën penitenciare

 **Rekomandim për Projekt-ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” me qëllim trajtimin e tyre në baza të barabarta dhe pa diskriminim.**

Komisioneri ka dërguar rekomandim Kuvendit lidhur me projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, propozimet e dërguara konsistojnë në këto drejtime kryesore:

- Të paraburgosurit dhe të dënuarit që janë me aftësi të kufizuara, të vihen në punë duke i ofruar “një përshtatje të arsyeshme”, sipas llojit të punës ose duke e përdorur punën për qëllime terapeutike.
- Komisioneri të shtohet në institucionet ku të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të paraqesin ankesë ose kërkesë me shkrim ose me gojë kundrejt personelit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.
- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të mund të vizitohen pa autorizim edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Etj

- ✚ **Rekomandim për projektligjin “Për policinë e burgjeve” me qëllim përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Burgjeve në baza të barabarta dhe padiskriminim.**

Komisioneri i ka dërguar rekomandime Kuvendit lidhur me projektligjin “Për policinë e burgjeve”. Propozimet e dërguara konsistojnë në këto drejtime:

- Ndalimi i kontrollit të korrespondencës të personave e dënuar me burgim apo të paraburgosurve me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të ndalohet kontrolli i korrespondencës së personave të dënuar me burgim dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga Policia e Burgjeve.
- Heqja e kufizimit të moshës në kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve etj.

1.8.1.5 Rekomandime për çështje të veçanta

Në zbatim të kompetencës ligjore për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin për vitin 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë rekomandimet e mëposhtme për çështje të veçanta:

- ✚ **Rekomandime lidhur me zbatimin e parimit të barazisë gjinore në organet e emëruara të pushtetit vendor.**

Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me UN Women Shqipëri ka kryer studimin “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor”, ku manifestohet diskriminimi gjinor në Shqipëri, në nivele të larta drejtuese në vetëqeverisjen vendore. Studimi, paraqet situatën e njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) në lidhje me respektimin e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjit Nr.9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, duke konstatuar por dhe duke propozuar rekomandime thelbësore si më poshtë:

- Nevoja për ndryshimin e Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” duke e shtirë kompetencën e monitorimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi edhe në këtë aspekt. Mosrespektimi i përcaktimeve të bërë në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore” për përfshirjen dhe përfaqësimin e gruas në këtë nivel të pushtetit, ka nevojë të monitorohet në vijimësi, të ndëshkohet administrativisht dhe/ose të ndërmerren masa të tjera për të realizuar në praktikë atë synim që ka pasur Ligjvënësi me miratimin e këtij ligji dhe duke siguruar edhe plotësimin e detyrimeve ndërkombëtarë të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” rezulton se nuk ka parashikuar një autoritet që do të mbikëqyrë respektimin e detyrimit të vendosur nga neni 15, shkronja “a” të vetë këtij ligji. Është i nevojshëm parashikimi i një mekanizmi monitorues dhe

sanksionues në lidhje me këtë dispozitë në mënyrë që të garantohet zbatimi efektiv i saj.

- Rezulton se Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ka nevojë të rishikohet në disa aspekte të tjera të tij. Si ilustrim në këtë ligj në nenin 28, parashikohet se Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për shkeljen e detyrimeve të përcaktuara nga neni 26 i ligjit. Neni 26 trajton çështjet e barazisë gjinore në media. Ky nen në paragrafin e dytë, përcakton se, ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufzime të njëres prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.
- Inspektorati Shtetëror i Punës nuk mund të jetë autoriteti përgjegjës në lidhje me detyrimet që vendos neni 26 i Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Ky shembull tregon se, është i nevojshëm rikonsiderimi në tërësi i autoriteteve përgjegjëse të cilat duhet të monitorojnë zbatueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në mënyrë që të garantohet zbatueshmëria e detyrimeve të këtij ligji, me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuara në ligj.
- Gjithashtu edhe vendosja e kuotës 30% për këshillat bashkiakë në nenin 15 është tashmë më e ulët se sa parashikimi që bën Kodi Zgjedhor i cili e ka rritur në 50%.
- Po ashtu, neni 15 vendos sanksione ndërkohë që edhe Kodi Zgjedhor vendos sanksione për listat shumëëmërore të subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme, madje i jep një kuptim të ndryshëm edhe vetë listave shumëëmërore me përfaqësim të grave në to.
- Nevojiten ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me qëllim adresimin e kuotës gjinore prej 30 %, sipas parashikimeve të nenit 15 të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Në nenin 64, shkronjat “f” dhe “g” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , përcaktohet se Kryetari i Bashkisë ka kompetencën që të vendosë për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi, si dhe të emërojë e shkarkojë punonjësit e tjerë të strukturave dhe njërive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil. Rekomandohet ndryshimi i shkronjave “f” dhe “g”, të nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke përcaktuar se Kryetari i Bashkisë ushtron këto kompetencat duke respektuar Ligjin “Për barazinë gjinore”.

- Është e nevojshme marrja e masave ligjore dhe krijimi i një mekanizmi efikas që të garantojë përfaqësimin e gruas në rastet e rekrutimit të punonjësve në administratën publike vendore. Aktualisht ky mekanizëm mungon. Në këtë aspekt nuk ka statistika se sa është numri i grave që punojnë në administratën vendore, dhe për më tepër duhet të shihen me kujdes dhe me prioritet gratë që mbajnë ose aspirojnë të mbajnë pozita drejtuese të nivelit të mesëm dhe të lartë në administratën publike vendore. Legjislacioni për shërbimin civil duhet të ndryshohet me qëllim që të garantojë jo më pas se 30 % e drejtuesve të administratës publike vendore janë të mbajtur nga gjinia më pak e përfaqësuar, si dhe duhet të përmbajë incentiva të mjaftueshme për të arritur këtë objektiv.
- Në të gjitha entet, shoqëritë tregtare, agjencitë, etj., që krjon pushteti vendor duhet të jetë e detyrueshme respektimi i kuotës gjinore të përbërjes së tyre, si në raste e postit menaxhues ashtu edhe të përbërjes së këshillave drejtues, administrativ, etj. Kjo kërkesë duhet të reflektohet së pari në ligjin *"Për vetqeverisjen vendore"* dhe duhet të zbatohet që në çastin e parë kur këshillat bashkiakë vendosin krijimin dhe/ose përbërjen e tyre. Edhe për këto çështje Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të ketë kompetencën të verifikojë situatën faktike dhe të marrë masa ligjore për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas edhe në këtë aspekt të organizmit të pushtetit vendor.
- Çështja e barazisë gjinore në shërbimin publik vendor dhe në çdo organ apo agjenci të emëruar prej tij duhet të shihet edhe nën këndvështrimin e ndryshimit të mentalitetit, veçanërisht kur merren parasysh ndryshimet e mëdha që janë evidente mes zonave urbane të zhvilluara në Shqipëri dhe atyre bashkive që janë të vogla apo në pjesët periferike të këtij zhvillimi. Ndaj hapi i parë i ndryshimeve ligjore duhet të shoqërohet edhe me mekanizëm ndërgjegjësimi për të nxitur dhe zhvilluar barazinë e plotë gjinore edhe në bashki. Një detyrë e tillë nuk është vetëm përgjegjësi e vetëm një institucioni, por e të gjithë mekanizmit shtetëror që duhet ta mundësojë atë duke krijuar ura bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe median.
- Çdo bashki duhet të ketë evidenca të qarta dhe të publikueshme (psh. në faqen e internetit apo në mjete të tjera) në lidhje me çështjet e barazisë gjinore. Statistikat duhet të jenë të përditësuara dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku i gjerë. Bashkitë ligjërisht duhet të kenë detyrimin e qartë që të mbajnë këto statistika, t'i përditësojnë ato, si dhe t'i dërgohen zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Duhet të përcaktohet qartë në akte nënligjore të kryetarit të bashkisë dhe/ose këshillit bashkiak funksioni apo sektori pranë Bashkisë që adreson dhe raporton evidencën mbi përfaqësimin gjinor duke pasqyruar edhe analizën përkatëse.

Rekomandime lidhur me problematikat e konstatuara për transportin publik vendor për persona me aftësi të kufizuara.

Komisioneri realizoi monitorimin e aksesueshmërisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare. Qëllimi i raportit është paraqitja e situatës së njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) në lidhje me respektimin e Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” në kombinim me Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke konstatuar, por dhe duke rekomanduar zgjidhje për rregullimin e situatës të cilat i janë adreuar institucioneve kompetente. Komisioneri ka adresuar rekomandimet si më poshtë:

- Marrja e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të kompetencës, për plotësimin e legjislacionit, me qëllim bërjen të mundur që kategoritë e personave me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre të marrin të njëjtat përfitime dhe lehtësira në transport, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.
- Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të kompetencës, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar) dhe nenit 11, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, (i ndryshuar), si dhe të nenit 85, të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Marrja e masave të shpejta nga bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse (përfshirë institucionet në nivel qendror) për të garantuar një transport pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara për të siguruar akses pa barriera për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Organet e pushtetit vendor të ushtrojnë kompetencat e tyre për të përcaktuar fondin e kompensimit për kategoritë e personave që përfitojnë lehtësira në transport, për transportin qytetas dhe rrethqytetas, në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.
- Krite me të detajuara për kushtet që mjetet e transportit të përshtatura, sipas VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 (pikës 9, të Kreut II) duhet të plotësojnë mund të rregullohen specifikisht nga legjislacioni përkatës i transportit, meqënëse VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, është shumë pak e fokusuar në përshtatshmërinë e mjeteve të transportit.

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor, me qëllim koordinimin e punës ndërmjet tyre në funksion të përmbushjes në mënyre efektive të detyrimeve ligjore dhe standarteve të aksesueshmërisë. Kjo pasi edhe pse transporti publik vendor është funksion i pushtetit vendor, ndërveprimi pushtet vendor - qendror është i nevojshëm, pasi pikë së pari rregullimi i përgjithshëm bëhet nga pushteti qendror dhe ai vendor është përgjegjës për zbatimin. Së dyti ndërveprimi është i domosdoshëm pasi pjesa e financimit të transportit publik vendor është e përbashkët, veçanërisht në drejtim të tarifave të transportit të udhëtarëve, që subvencionohen nga shteti.
- Pushteti Vendor duhet të përdori rezultatet e këtij raporti për të hartuar planet për ndërhyrje dhe për caktimin e buxheteve. Institucionet përgjegjëse të monitorimit të transportit të urbanit, duhet të ndërgjegjësohen më shumë për aksesueshmërinë e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të mundësojnë zbatimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e buxheteve.
- Mekanizmi i monitorimit nga vetë Bashkitë për Kompanite Private duhet të jetë i unifikuar dhe periodik nga të gjitha Bashkitë të cilat në rastet e linjave të transportit urban janë autoriteti përkatës për dhënien e Liçencave. Duhet të intensifikohen përpjekjet me qëllim jo vetëm vënien e gjobave apo masave disiplinore por mbi të gjitha për sensibilizimin e operatorëve ofrues të shërbimit mbi rëndësinë e një transporti gjithpërfshirës si një factor që lidhet me përfshirjen sociale dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara dhe me zhvillimin e shoqërisë në tërësi.
- Intensifikimi i kontroleve në lidhje me përshtatshmërinë e mjeteve të transportit publik me një mekanizëm efikas dhe të unifikuar kontrolli ku personat me aftësi të kufizuara të mund të ankohen, si dhe vendosja e masës administrative për operatorët përsëritës.
- Të merren masa nga Bashkitë për të bashkërenduar punën me institucionet kompetente për ofrimin e trajnimit të specializuar të stafeve që ofrojnë shërbime në linjat e transportit publik, i cili duhet të jetë i detyrueshëm dhe periodic, si dhe të përfshihen certifikata e trajnimeve të operatorëve dhe stafeve të tyre si kusht në procedurat e pranimeve.
- Liçencat nga ana e Bashkive nuk duhet t'u jepen operatorëve që nuk garantojnë përshtatshmërinë e mjeteve të transportit publik për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, në procedurat e pranimeve të vendoset si kusht përshtatshmëria e mjeteve të transportit rrugor për personat me aftësi të kufizuara.

Rekomandim në lidhje me çështjet e mbrojtjes nga diskriminimi në shpërblim në marrëdhëniet e punës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përgjigje të kërkesës së një subjekti privat, si dhe në përmbyllje të misionit për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi, në ushtrim të kompetencës për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, ka rekomanduar dhe udhëzuar në lidhje me situatën e mëposhtme:

- A përbën llogaritja e shpërblimit vjetor në përpjestim me kohën e punuar nga punonjësi dhe duke zbritur periudhën kur nuk është punuar për shkak të një leje të marrë nga punonjësi, (si psh. leja e lindjes, leja prindërore) veprim diskriminues përkundrejt këtij punonjësi, në kuptim të nenit 9 dhe nenit 115 të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”?

Në lidhje me sa më sipër Komisioneri, udhëzon:

- Llogaritja e shpërblimit vjetor për punonjësit me leje lindje, në referim të nenit 114 të Kodit të Punës, në mënyrë të ndryshme nga dhënia e masës së shpërblimit si gjithë punonjësit e tjerë që kanë punuar gjatë të gjithë vitit, përbën veprim diskriminues përkundrejt këtij punonjësi, në kuptim të nenit 9, nenit 115 të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Llogaritja e shpërblimit vjetor për punonjësit me leje prindërore, në referim të nenit 114 të Kodit të Punës, në përpjestim me kohën e punuar, duke u zbritur periudha ku nuk është punuar për shkak të lejes, nuk përbën veprim diskriminues përkundrejt këtij punonjësi, në kuptim të nenit 9, nenit 115 të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Nëse punëdhënësi jep një shpërblim si inkurajim për punonjësit, apo shpërblime të një natyre që nuk kushtëzohen me punën e kryer në të shkuarën, ky shpërblim duhet të jepet për të gjithë punonjësit pavarësisht nëse punonjësi ka qenë me leje lindje apo leje prindërore.

1.9 Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloji çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga

diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vitit 2019 KMD ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin etj, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me daljet në TV, si:

Janar - RTSH

Shkurt - Scan Tv, A2 CNN dhe TV Korça

Mars - Ora News, Top Channel, Klan Plus, Antena TV në Shkodër dhe TV Korça

Prill - SCAN TV, RTSH, TV Korça, TV1 Channel dhe Antena TV në Shkodër,

Maj - VOA, ORA News, ATSH dhe TV Lobi në Korçë

Qershor - Top Channel, RTSH dhe A2 CNN

Korrik - Zëri i Amerikës, TV1 Channel dhe Star Plus në Shkodër,

Gusht - News 24

Shator - VOA, Tv Kombi, Tv Apollon dhe Scan Tv

Tetor - Ora News, Tv Korça dhe Lobi, Tv Rozafa dhe Antena Nord Shkodër

Nëntor - Tv Kombi, Tv Apollon dhe Tv Korça, Tv1 Chanel Shkodër

Dhjetor - Tv Korça, Lobi, Star Plus Shkodër, Tv Skampa, Ora News

Në median e shkruar

Panorama, Tema Tv, BIRN, Shekulli dhe Insajderi.com

1.9.1 Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media

Gjatë vitit 2019, Komisioneri dhe Zyra kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

JANAR

- Në bashkëpunim me organizaten "Open Mind Spectrum Albania Omsa" dhe "Human Rights Campaign HRC nga Washington Dc", në OMSA/HRC Workshop u diskutua mbi temën "Barazia e LGBTIQ në Shqipëri"
- Në bashkëpunim me ANAD u realizua takimi pranë KMD në lidhje me "Monitorimin e KMD për Individët me aftësi të kufizuara."

- Komisioneri mori pjesë në diskutime dhe prezantimin e rezultateve të vlerësimit të ndërmjetëm të zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar.
- Me pjesëmarrjen e Komisionerit dhe z. Arben Seferaj, kryeinspektori i Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për të bashkërenduar të gjitha veprimet për të realizuar mbrojtjen e qytetarëve kundrejt diskriminimit në punë.
- Komisioneri mori pjesën në takimin e organizuar nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome mbi temën “Përdorimi i gjuhës diskriminuese në media, e cila prek veçanërisht minoritetin Rom/Egjiptian dhe pakicat e tjera kombëtare.
- Nën drejtimin e presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, Komisioneri mori pjesë në takimin e Aleancës për Dhurimin e Gjaku, në analizën e punës për 6 mujorin e saj të parë.
- Komisioneri takoi në Tiranë znj. Jean Freedberg zv.drejtor i Human Rights Campaign (HRC), për të biseduar rreth komunitetit LGBTI në vend dhe problematikave të ndryshme.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, priti në një takim drejtoreshën e UNDP-së, znj. Limya Eltayeb.

SHKURT

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në emisionin “Dita Jonë”, në A2CNN, për të treguar situatën diskriminuese në Shqipëri.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi takim me Z. Nikoll Gjurgjaj përfaqësues i Shoqatës Maqedonase “Ilinden”.
- Komisioneri realizoi takimin me përfaqësues nga Kosova lidhur me planin e veprimit dhe aktivitete e përbashkëta sipas marrëveshjes së nënshkruar.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në diskutim me rastin e 10 Vjetorit të krijimit të shoqatës maqedonase “Ilinden”-Tiranë.
- Komisioneri mori pjesë në emisionin “Për të Fol”, në Scan Tv, për të biseduar për raportin vjetor të KMD dhe gjendjen e diskriminimit në vend, punën që po bëhet nga institucioni dhe sfidat e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, Kuvendi i Shqiperisë.
- Komisioneri mori pjesë në takimin e parë LGBT, të palëve të interesuara për 2019, Ambasada e Mbretërisë së Holandës. (Invitation to first LGBT+ Stakeholders Meeting for 2019, Embassy of the Kingdom of the Netherlands.)
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në një takim të organizuar nga Coc Holande dhe Komiteti i Helsinkit (NHC) mbi Luftën Kundër Diskriminimit dhe Mbrojtja e të Drejtave LGBTI në Shqipëri, të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës. (Dutch National

Police and COC Netherlands, we are currently implementing a project on 'Countering discrimination and protecting lesbian, gay, bisexual, transgender and intersex persons' (LGBTI) rights in Albania', funded by the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands, Dutch National Police and COC Netherlands).

- Komisioneri realizoi takimin me Zv.Kryetarin e Minoriteteve Z.Goci.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në seminarin mbi: "Fuqizimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrjen politike", të organizuar nga Women's Democracy Network, WDN.
- Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të njerzve që nuk dëgjojnë (ANAD).
- Komisioneri zhvilloi një takim pune me Zv/ Ambasadorin e Greqisë në Tiranë Z. Grigorios Delavekouras, Këshilltar i Parë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në kuadër të projektit FORWORK Integrimi i refugjateve dhe azilkërkuesve në tregun e punës nëpërmjet formimit profesional, Adriapol, Agjencia e arsimit, formimit profesional dhe kualifikimeve.

MARS

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin më Këshillin Kombëtar të Integritetit në BE, Kuvendi i Shqipërisë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin e zhvilluar nga World Bank për Ndërprerjen e Ciklit të Përgjithshmit të Romëve në Ballkanin Perëndimor.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Planin dhe aktivitetet aktuale në portofolin e të Drejtave të Njeriut të Prezencës së OSBE-së për këtë vit dhe për të shqyrtuar dhe diskutuar aktivitetet potenciale të përbashkët, OSBE.
- Komisioneri mori pjesë në diskutimin mbi "Të drejtat e grave dhe vajzave Rome - Roli i Kuvendit të Shqipërisë në promovimin dhe mbrojtjen e tyre", Kuvendi i Shqipërisë.
- Komisioneri mori pjesë në Tryezen e rrumbullakët mbi prezantimin e "Standarteve të përshtatshmërisë fizike dhe informacioneve që duhet të garantohen në institucionet e sistemit të drejtësisë për personat me aftësi të kufizuara", ADRF & Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takim me OJF me rastin e ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial, si dhe vizitoi Qendren Sociale Tufin.
- Komisioneri mori pjesë në Wake Up në Top Channel për të diskutuar Raportin vjetor të KMD, si dhe për të diskutuar për të gjitha kategoritë e diskriminuara,

duke përfshirë gjithashtu diskriminimin për shkak të arsimimit, aftësive të veçanta dhe ai racor.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Seminar mbi Kartën Sociale Evropiane, Ministria e Finances dhe Ekonomisë dhe Departamenti Kartës Sociale Europiane, KE.
- Komisioneri mori pjesë në takimin e realizuar nga Kuvendi i Shqipërisë për të diskutuar mbi projektligjin “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Eventin për “Ditën Kombëtare e Ambasadorit të Greqisë”, Embassy of Greece, Mrs Eleni Sourani & Mr. Panagiotis Zografos.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi takimin informues me student suedez Amanda Herrstrom mbi “The effect of Albania’s accession to the EU on the protection of the Roma minority”
- Komisioneri mori pjesë në Ligjërime të Hapur në Universitetin Mesdhetar mbi “Legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin me Z. Amarildo Fecanji, Executive Co-Director ERA, LGBTI Equal Rights Association for the Western Balkans and Turkey.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në seminarin për “Fuqizimi i sindikatave për përmirësimin e pagave dhe kushteve të punës në sektorët e tekstilit dhe të këpucëve në Shqipëri”, All European Trade Union and Industri Global Union.
- The World Bank mission on Sexual Orientation and Gender Identity (SOGI) informoi KMD me një prezantim të punës së Bankës për çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe ofron mbështetje për institucionin e KMD lidhur me çështjet gjinore.
- Komisioneri mori pjesë në emisionin e Ora News, për të diskutuar për raportin vjetor të KMD.

PRILL

- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në takimin e Grupit të Deputetëve “Miq të fëmijëve”, në Kuvend.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Konferencën e Parë Kombëtare për Spektrin Autik, CLUBI Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me CSA.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), Bashkia Diber, Partneritete për fuqizimin e sistemit vendor të ndërhyrjeve për aftësinë e kufizuar, World Vision Albania.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin e tretë të Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal, KIE.

- Komisioneri mori pjesë në Seminarin trajnues me temë “Gratë në Leadership”, organnizuar nga Policia e Shtetit, dhe misioni PAMECA.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin informues dhe sensibilizues në Ditën Ndërkombëtare të Romeve, Rrjeti i organizatave Rome & Egjiptiane në Korçë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takim me dy përfaqësues të Komisionerit të Lartë të OSBEs për Minoritetet Z. William Romans dhe Znj. Elena Gjoreska për progresin dhe nevojat ne implementimin e ligjit për minoritetet.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takim me KIE për të diskutuar mbi Reforma në Drejtesi, në Kuvendin e Shqipërisë.
- Komisioneri zhvilloi takimin me përfaqësues të UN.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në seancën plenare në Kuvendin e Shqipërisë për të prezantuar raportin e veprimtarisë Vjetor të KMD për vitin 2018.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin e organizuar nga Kryetari i Kuvendit bashkë me 21 institucionet e Pavarura, për Përmbushjen e Rekomandimeve të Rezolutave të Kuvendit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në emisionin “Për të Folur” në Scan TV.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në takimin për Procedurat për zgjedhjen e anetarit të Shqipërisë pranë Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Ç’njerezor ose Degradues, në Kuvend.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi takim me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Zyrat Arsimore Rajonale, në Shkodër.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Përfaqësuesin e UNICEF Z. Roberto De Bernardi vizituan shkollën 9 vjeçare “Ismail Qemali” për të diskutuar mbi problem të ndryshme si bulizmi, përjashtimi i fëmijëve nga edukimi dhe gjetja e instrumentave për të ndërtuar bashkëpunim, shkollë-komunitet-institucione.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takim me Avokatin e Popullit të Maqedonisë Veriut, në kuadër të bashkëpunimit rajonal të institucioneve të pavarura të shteteve, si Kosove, Maqedonia e Veriut dhe Shqipërisë.
- KMD mori pjesë në takimin e “Second Advisory Group Meeting of the Joint CoE/EU ROMACTED Programme” në “Promoting Good Governance and Roma Empowerment at Local Level”.
- Komisioneri mori pjesë në takimin e organizuar nga Ambasada Hollandeze në Tiranë, me rastin e ditës së “Celebration of King’s Day”.

MAJ

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Samitin e Parë Kombëtar i të Rinjve, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve në Shqipëri (ANYN) & Child and Youth Policy Hub Albania & Aleanca Kombëtare e Studentëve.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Konferencë “European Regional Forum on Education, Language and the Human Rights of Minorities”, UN Special Rapporteur on minority issues & the Tom Lantos Institute.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Seance dëgjimore publike “Të drejtat e grave dhe vajzave Rome - Roli i Kuvendit të Shqipërisë në promovimin dhe mbrojtjen e tyre”, Kuvendi.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Trajnimin për një reagim profesional policor Policimi i Krimeve të Urrejtjes kundër personave LGBTI, Netherland, Helsinki Committee.
- Pjesëmarrje e KMD në “Project Standards on Equality Bodies”, në Belgjikë nga Equinet.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi prezantoi studimin: “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor” ,
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Festivalin e 10-të të Diversitetit & parada 4-të e Krenarisë, “Ambasada PINK Shqipëri”, Shtëpia e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri (HRH) dhe CRCA Shqipëri.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në 20 Vjetorin e Shoqatës “Ndihamoni Jeten”.
- Komisioneri dhe përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Ditën e hapur: Të drejtat LGBTI janë të drejtat e njeriut! (Java IDAHO 2019)", Avokati i Popullit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me Ministren e MAS për mundësi bashkëpunimi për përfshirjen e ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në kurrikulat shkollore.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin mbi Shqyrtimin projektvendimit “Për një ndryshim në Strukturën dhe Organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në Kuvend.
- Komisioneri mori pjesë në konsultime për “Identifikimin e problematikave dhe vështirësive të hasura gjatë veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe rekomandimet përkatëse për nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së tyre”, në Kuvend.
- Përfaqësuesit e Zyrës së KMD morën pjesë në Konferencën Kombëtare për “Aksesueshmëria dhe sfidat për gjithëpërfshirje”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas”.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Mbledhjen e Grupit Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK) për monitorimin e ecurisë së

Planit Kombëtar të Veprimit të personave LGBTI, për vitin 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për “Fëmijët dhe Edukimi Mediatik: Përballë Sfidave të Reja”, Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).
- Komisioneri mori pjesë në Ditën e Kushtetutës së Norvegjise, Ambasada Norvegjeze.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Konferencën Kombëtare me temë “Aksesi efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara”, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF).
- Komisioneri dhe përfaqësues nga Zyra e KMD mori pjesë në “Tirana Pride Parade 2019”, The Alliance Against LGBT Discrimination, PRO LGBT & STREHA.
- Komisioneri zhvilloi një takim me kreun e delegacionit europian Z. Soreca.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda zhvilloi takim me ECRI, mbi raportin dhe vizitën e Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Shqiperinë.
- Komisioneri zhvilloi takimin me Znj. Dicky Methorst, koordinatorë rajonale e grupit të Rule of Law.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Takimin e parë të “Komitetit rajonal për rritjen e qasjes së grave në punësim”, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC).
- Komisioneri mbajti një Leksion të hapur në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në “6-Th International Conference on Humanities – Ich 2019 “Gender Studies: Law, Media And Society”, Kolegji Universitar “Bedër”.

QERSHOR

- Në kuadër të Festës së Fëmijëve, 1 Qeshorit, u organizua aktiviteti nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe OJF.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në forumin “Fëmijët brenda sistemit të drejtësisë: Monitorimi i sistemit të mbrojtjes ligjore dhe aksesit të barabartë në drejtësi”, të organizuar nga “Save the Children” dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.
- Komisioneri mori pjesë në emisionin “NE” në RTSH2, për të biseduar rreth gjuhës së shenjave dhe personat me aftësi ndryshe.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konsultën kombëtare “Reforma e aftësisë së kufizuar dhe dialogu me grupet e interesit”, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në "Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë 2016-2020: Zbatimi dhe Masat Prioritare për 2019 – 2020", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në hulumtimin “Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Shqipëri,” Aleanca Gjinore për Zhvillim.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një Leksion të hapur në Kolegjin Universitar të Biznesit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Konferencën rajonale “Roli i fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe partnerët e saj.
- Komisioneri mori pjesë në konferencën përmbyllëse të Projektit “Fuqizimi i grave që nuk dëgjojnë në Shqipëri nëpërmjet informimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit”, ANAD & UNDP Shqipëri.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në takimin me temë “ Mos më trego çfarë nuk mund të bëj, shif çfarë jam i aftë të bëj” Caritas.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në 20 vjetorin e Qendrës Europiane.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në takim për “Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi përmes edukimit ligjor të publikut”, organizuar Qendra ALTRI.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në emisionin “Hipokrati” mbi “Rastet e Diskriminimit në Shëndetësi”, në emisionin në “Top Channel”.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Aksion Komunitar me temë “ Ndalë gjuhës së urrejtjes ndaj Minoritetit Egjiptian, në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Minoritetit Egjiptian.
- Komisioneri mori pjesë në diskutime për hartimin e një ligji të integruar kundër dhunës ndaj grave e vajzave, të organizuar nga UNDP Shqipëri në bashkëpunim me Avokatin e Popullit.
- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në takimin e organizuar nga Fundacioni “Së Bashku” për “E drejta për jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar.”

KORRIK

- Përfaqësues nga Zyra e KMD morën pjesë në Takimin me temë “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët”, Projekt i financuar nga

Bashkimi European dhe zbatuar nga PNUD, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- KMD mori pjesë në aktivitetin me temë “Mbështetje për integrimin e fëmijëve rom në edukimin parashkollor dhe atë shkollor”
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me UNDP Shqipëri, Avokati i Popullit dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale organizuan një tryezë konsultimi me temë “Parimet, politikat dhe standardet e një mjedisi të sigurtë pune”.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi një takim përfaqësuesit e Agjencisë Franceze për Zhvillim dhe Expertise France, për të folur në lidhje me çështjet gjinore dhe diskriminiminspecifik në vendin e punës, në veçanti të sektorit privat, si dhe mbimekanizmat që bëjnë të mundur në qasjen e mundësive ekonomike.
- KMD mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Fëmijët në median audiovizive”, të organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe AMA.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizoi një takim përfaqësuesit e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim, për të diskutuar mbi projektin “ALBE”, i cili përqendrohet tek reformat e ndërmarra në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24 të legjislacionit të BE, përkatësisht fushat specifike si gjyqësori dhe krimi i organizuar.
- KMD mori pjesë në prezantimin e Raportit të Monitorimit për shpërndarjen endihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësitë kufizuar.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori pjesë në takimibn me temë “Fuqizimi i qëndrueshmërisë komunitarenëpërmjet njësisë vendore kundërekstremizmit”, të organizuar nga QendraNdërfetare në Elbasan dhe IRI.
- KMD mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të projektit, sfidat në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave sociale për grupet në nevojë.

SHTATOR

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me autoritetet lokale të Fierit përuruan çeljen e zyrës rajonale të KMD në Fier
- KMD mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga World Vision, “20 vjet World Vision Albania & Kosovo”.
- KMD mori pjesë në Grupin e punës së EQUINET, mbi standartet dhe projektet e institucioneve të barazisë, që po mbahet në Francë.
- Komisioneri mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë për 25 vjetorin e ECRI (Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës) me temë “Në rrugën drejt barazisë efektive - ndaj racizmit dhe intolerancës së nevojshme”.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin e radhës të Këshillit Kombëtar i Integritetit European, tematika kryesore: “Ecurinë dhe të

rejat më tëfundit nga institucionet në kuadër të negociatave të anëtarësimit nga muaji Mars 2019” si dhe “Progresin e realizuar nga institucionet e pavarura për adresimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në raportin e vitit 2019 për Shqipërinë, si dhe nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri”.

- KMD organizoi një tryezë diskutimi mbi amendimet e ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me aktorët kryesorë shoqërore që operojnë në fushën e të drejtave.
- Zyra e KMD mori pjesë në aktivitetin Tryezë Konsultuese: Të sigurt për të mësuar. Kjo tryezë synoi të punojnë për hartimin e një Plani Kombëtar për Shkolla të Sigurta për çdo Fëmijë.

TETOR

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën e IV rajonale të organeve të barazisë së Europës Juglindore, me pjesëmarrjen e rrjetit European EQUINET, në Podgoricë.
- KMD mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Komisioneri për të Dhënat Personale.
- Komisioneri mori pjesë në ceremoninë e hapjes së ekspozitës “Care and Dare” në Laç, organizuar nga Qendra Tirana Art, dhe Ambasada e Mbretërisë së Vëndeve të Ulëta në Tiranë, me fokus edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve mbi parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- KMD mori pjesë në Takim e Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të Equinet ne Bruksel, në të cilën u votuan shtete anëtare të Equinetit dhe u miratua plani i vitit 2020.
- KMD mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare me temë “Sfidat për prezentin dhe të ardhmen”.
- Zyra e KMD mori pjesë në konferencën e 24-tët të Equinet me temë “Sexual Harassment” në Brusel.
- Komisioneri mori pjesë në takim e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian me fokus sundimin e ligjit dhe progresi i bërë në luftën kundër krimit të organizuar.
- KMD mori pjesë në Forumin e dytë rajonal me temë: "Politikat e integruara, partneritetet gjithëpërfshirëse", promovimi i zbatimit të Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, si dhe “t’i japim fund dhunës ndaj grave” në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, një takim me Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, një takim me Arqipeshkëvin e metropolit Tiranës dhe Durrësit, një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Vëllazërisë Ungjillore, si dhe organizoi një takim në selinë e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Këto takime e kishin fokusin mbi nevojën që harmonia dhe toleranca fetare nuk

duhet të mbetet vetëm midis komuniteteve fetare, por për të gjitha grupet dhe komunitetet në shoqëri.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me ambasadorin e Bullgarisë në Tiranë, z. Momtchil Stoyanov Raytchevski me fokus tek urat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të barazisë Shqipëri Bullgari, dhe programeve për shkëmbim informacionesh dhe përvojash në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të Njeriut.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbajti për një séance informuese me punonjësit e kompanisë ndërkombëtare Shell Upstream Albania B.V, në Tiranë.
- Zyra e KMD mori pjesë në aktivitetin me temë: “Çeshtjet e dhunës me bazë gjinore dhe të diskriminimit ndaj të moshuarve. Sfida në identifikimin dhe trajtimin e rasteve”.

NËNTOR

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës organizoi një seminar me temë “Lufta ndaj gjuhës së urrejtjes”, në Universitetin e Elbasanit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me z. William Romans, Këshilltar i lartë ligjor, pranë Komisionerit për minoritetet kombëtare në OSBE.
- Takimi III Rajonal i Komisionerëve për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut me fokus bashkëpunimin institucion për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën e katërt vjetore rajonale "Të drejtat tona, e ardhmja juaj" të organizuar nga ERA - LGBTI Shoqata për të Drejtat e Barabarta për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.
- KMD mori pjesë në aktivitetin "Egypt Day", në kuadër të ditës botërore të Jetimëve. Ideuar dhe mbështetur nga Ambasada e Shtetit të Egjiptit në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë.
- Klupi i prindërve të fëmijëve me autizëm në bashkëpunim me KMD organizuan ekspozitë me piktura të fëmijëve të spektrit Autik.
- Në bashkëpunim me qeverinë Suedeze dhe pjesëmarrjes se 5 shteteve Shqipëri Mali i Zi , Moldavi, Kosove, Ukraine, edhe stafi i KMD zhvilloi vizitë në disa Institucione në Austri me fokus parandalimin dhe ndalimi i dhunës me bazë gjinore, promovimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave në shoqëri dhe fuqizimi i grave ekonomikisht.
- Në Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në marshim dhe aktivitetin “Ndërgjegjësimi komunitetit mbi efektet dhe adresimin e stereotipeve të dëmshme gjinore, si burim i dhunës ndaj grave në rajonin e Elbasanit”.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbajti një Leksion të hapur në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, mbi gjendjen e diskriminimit në vend dhe rolin e KMD për promovim e barazisë dhe ndreqjen e situatave diskriminuese.

DHJETOR

- Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën e 8-të ndërkombëtare me temë: "Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe harmonizimi i legjislacionit, si premisë e integritetit evropian të vendeve të Ballkanit perëndimor", të organizuar nga universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani".
- Komisioneri mbajti një fjalë në Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit: "Liri pa urrejtje - Liria e shprehjes përballë të drejtave të njeriut".
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në diskutimin Publik - "Çështje të të drejtave të punëtorëve/ëve në sektorin e tekstilëve e këpucëve në Shqipëri", e organizuar nga Aleanca Gjinore, në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës, Zyrën e Punës, Dhomën e Industrisë në Elbasan, organizatat e shoqërisë civile, etj.
- Në kuadër të mbylljes së fushatës "16 Ditët e Aktivizmit", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit, dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, zhvilluan një bashkëpunim me grate që kryejnë dënimin në Burgun e Grave Tiranë në kuadër të respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim.
- Komisioneri është bërë pjesë e fushatës ndërgjegjëse për personat interseks dhe të drejtat e tyre. Përmes një spoti të realizuar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri synohet informimi dhe ndërgjegjësimin i shoqërisë për të drejtat e personave intersex.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbajti një Leksion të hapur në Universitetin e Korçës, "Fan S. Noli". Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe promovimi i barazisë, si dhe roli i KMD

1.10 Veprimtaria monitoruese e KMD

1.10.1 Barazia Gjinore në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me UN Women Shqipëri ka kryer studimin "Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor", ku manifestohet diskriminimi gjinor në Shqipëri, në atë të niveleve të larta drejtuese në vetëqeverisjen vendore.

Raporti, paraqet situatën e njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) në lidhje me respektimin e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në kombinim me Ligjin Nr.9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, duke konstatuar por dhe duke propozuar e rekomanduar zgjidhje për rregullimin e situatës.

Do të jetë praktikë e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryerja e studimeve dhe raporteve të veçanta në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile, me qëllim evidentimin e situatave diskriminuese dhe propozimin për zgjidhjen e tyre me rekomandimet dhe masat përkatëse.

1.10.2 Monitorimi i transportit urban për PAK

Monitorimit i aksesueshmërisë së transportit publik vendor për persona me aftësi të kufizuara.

Në përmbushje të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2019”, për realizimin e monitorimit të aksesueshmërisë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, KMD në funksion të veprimtarisë së tij për promovimin e një shoqërie me mundësi dhe shanse të barabarta dhe duke luftuar çdo veprim apo mosveprim që sjell diskriminim, synon të ndërmarrë të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar, për t’i garantuar të drejtën për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Qëllimi i raportit është paraqitja e situatës së njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) në lidhje me respektimin e Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” në kombinim me Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke konstatuar, por dhe duke propozuar e rekomanduar zgjidhje për rregullimin e situatës.

Legjislacioni ekzistues parashikon ofrimin e transportit me lehtësira për personat me aftësi të kufizuara në zonat urbane dhe rurale dhe vende të posaçme për ta. Respektimi nga shoqëritë e transportit i standardeve të aksesueshmërisë në shërbim është përgjegjësi e organeve të qeverisjes vendore, të cilat edhe kanë përzgjedhur fituesit e kontratave të transportit. Në funksion të realizimit të këtij procesi monitorues, është përgatitur një pyetësor, mbi kushtete dhe standartet që plotësojnë aktualisht subjektet të cilët ofrojnë këtë shërbim dhe j’u dërgua Bashkive të vendit për plotësim. Monitorimi tregoi se personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen

me transport të papërshtatur, e për rrjedhojë të mos kenë akses të plotë e pa barriera në shërbimet transportit urban në komunitetet ku ata banojnë.

Njëkohësisht, është dërgur edhe pyetësori për transportin interurban në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke qenë se respektimi nga shoqëritë e transportit të standardeve të aksesueshmërisë në shërbim është përgjegjësi e kësaj Ministries. Përgjigjet nga ky institucion lidhur me pyetësin ishin të pamjaftueshme dhe nuk i korrespondonin pyetjeve konkrete, por referonin bazën ligjore mbi të cilën ishte ndërtuar pyetësori, ndaj Institucioni i KMD e ka pasur të pa mundur realizimin e monitorimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në transportin interurban.

1.10.3 Bashkëpunime

KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë

Stafi i KMD është përfshirë në shtatë grupe pune të rrjetit EQUINET gjatë periudhës Janar - Qershor 2019, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimime të praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Europës, konkretisht në:

- Grupin e Punës për Legjislacionin e Barazisë
- Grupin e Punës për komunikimin, strategjitë dhe praktikat
- Grupin e Punës për barazinë gjinore
- Grupin e Punës për hartimin e politikave
- Grupin e Punës për kërkimet dhe mbledhjen e të dhënave
- Projekti mbi standartet e Organeve të Barazisë
- Grupin e Punës për Lëvizjen e Lirë

Aktivitetet:

- Me datë 26 Mars 2019, u zhvillua mbledhja e Grupit të Punës për Hartimin e Politikave (Equinet), në Bruksel, ku mori pjesë anëtari i grupit të punës së KMD.
- Me datë 26 Mars 2019, përfaqësuesi i KMD mori pjesë në "Project Standards on Equality Bodies", në Belgjikë.
- Me datën 2 prill 2019, në Lisbon, Portugali u zhvillua takimi i parë i Grupit të Punës për Barazinë Gjinore (Gender Working Group). Temat e diskutura: "Trans and intersex rights"; "Gender based violence and harassment" dhe "Next European Commission Gender Equality Strategy".

- Më datë 5 Prill, 2019, një përfaqësues i Zyrës së KMD-së mori pjesë në takimin e Grupit të Punës për Lëvizjen e Lirë.
- Më datë 24 Prill 2019, dy përfaqësues të Zyrës së KMD-së, morën pjesë në takimin e Grupit të Punës për Legjislacionin e Barazisë, i cili u zhvillua në Bruksel. Në takim u diskutua mbi monitorimin e realizuar për rastet e komunikuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), për të cilat EQUINET po vlerëson mundësinë për të ndërhyrë si palë e tretë, si dhe monitorimin e vendimeve të GJEDNJ-së, ku gjykata ka trajtuar nenin 14 të Konventës.
- Më datë 23 Maj 2019, u organizua takimi i parë i Grupit të Punës Kërkimit dhe Mbledhja e të Dhënave në Lisbonë, Portugali. Temat e diskutuara: Organet e Equinet dhe statistikat e nivelit evropian, Përmirësimi i mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave për ankesat, hulumtimi i inteligjencës artificiale dhe organet e barazisë.
- Më Datë 27 -28 Qershor 2019, në bashkëpunim mes Equinet dhe Age Platform Europe, Berlin, Gjermani u zhvillua aktiviteti me temë 'Fenomeni i diskriminimit për shkak të moshës'.
- Më datë 23-24 Tetor 2019, u organizua mbledhja vjetore e Equinet dhe Konferenca "Sexual harrasment", në kuadër të 10 vjet #MeToo movement.

Rekomandimi i Equinet mbi Luftën kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në fushata zgjedhore - Prill 2019.

Në kuadër të fushatës zgjedhore europiane, Equinet - Rrjeti European i Organeve të Barazisë, publikoi "Rekomandimin mbi Luftën kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në fushata zgjedhore", duke nxitur promovimin e tij edhe në rang kombëtar.

Ky rekomandim adreson dhe ka në fokus:

- Parimin i përgjithshëm të barazisë
- Ndalimin e diskriminimit
- Gjuhën e Urrejtjes
- Adresimin e temave të ndjeshme
- Promovimin e përfaqësimit të barabartë në listat zgjedhore

KMD vlerësoi se 10 Rekomandimet mbi Luftën kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në fushata zgjedhore janë shumë të nevojshme për t'u ndjekur nga të gjitha subjektet zgjedhore dhe monitoruar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe Organizatat e Shoqërisë Civile, për të krijuar sinergjinë e promovimit të parimit të mosdiskriminimit, të barazisë dhe të tolerancës. Për arsyen sa më lart, si dhe bazuar në "Manualin e Promovimit dhe Shpërndarjes për Anëtarët e Equinet", të hartuar dhe

sugjeruara nga Equinet për vendet anëtare, KMD përqafoi iniciativën për promovimin e këtij Rekomandimi, duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

1. Përktheu në shqip “Rekomandimin mbi Luftën kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në fushata zgjedhore”, te Equinet (sipas modelit të tij).
2. Rekomandimi i Equinet në shqip, u publikua në faqen zyrtare të internetit të Equinet, në link: <http://www.equineteurope.org/Combating-discrimination-and-hate-speech-in-election-campaigns-1352>
3. Ka publikuar Rekomandimin në Website KMD, në link: <https://kmd.al/rekomandimin-mbi-luften-kunder-diskriminimit-dhe-gjuhes-se-urrejtjes-ne-fushata-zgjedhore/>
4. Ka publikuar Rekomandimin në Media Sociale: Facebook dhe Twitter, në link: <https://www.facebook.com/antidiskriminimi/>, <https://twitter.com/AntiDiskriminim/status/1118180008432930817>.
5. Në Facebook, KMD ndoqi një "strategji", duke ndërmarrë këto hapa:
 - Publikimi i Rekomandimit, etiketimi i Equinet dhe vendosja link (postuar me 18 Prill), duke prezantuar 10 Rekomandimet (në shqip) nepermjet një video (postuar më 22 Prill)
<https://www.facebook.com/antidiskriminimi/videos/1212421545635465/>
 - Duke publikuar veçmas, secilin nga 10 Rekomandimet, në ditë të ndryshme dhe duke i vendosur bashkëlidhur gjithashtu link-un e Rekomandimit të plotë, për secilin nga 10 postimet, realizuar gjatë periudhës Prill – Maj, si:
<https://www.facebook.com/antidiskriminimi/photos/a.598065836903242/2183058321737311/?type=3&theater>.
<https://www.facebook.com/antidiskriminimi/photos/a.598065836903242/2212760265433783/?type=3&theater>.
6. Ka shpërndarë Rekomandimin stafit të KMD me qëllim njohjen e përmbatjes së tij.
7. Ka dërguar Rekomandimin Parlamentit të Shqipërisë. Më 20/05/2019, Parlamenti shqiptar publikoi Rekomandimin në faqen e tij zyrtare, në link: <https://www.parlament.al/News/Index/8398>, duke informuar gjithashtu që i është shpërndarë të gjithë Deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë.
8. Ka dërguar Rekomandimin të gjitha Partive Politike. Së pari, është dërguar Rekomandimi 63 Partive Politike që janë regjistruar në zgjedhjet e fundit, 4 vite më parë. Me vonë, pasi analizuam se kush ka marrë njoftim dhe është ri-

regjistruar në këto zgjedhje, ia dërguam 21 Partive Politike të regjistruara në zgjedhjet e këtij viti, datë 30 qershor, që ishin në fushata zgjedhore.

9. Ka dërguar Rekomandimin Autoritetit të Medias Audiovizive në Shqipëri.
10. Ka dërguar Rekomandimin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Komisioneri z. Robert Gajda zhvilloi gjithashtu një takim me Kreun e KQZ-së, z. Klement Zguri, i cili u shpreh, ndër të tjera, se: Qëllimi i takimit ishte kërkesa e Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi për bashkëpunim me KQZ-në, në promovimin e fushatës "Rekomandim për luftimin e diskriminimit dhe fjalës së urrejtjes në fushatat zgjedhore", angazhim i Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë - EQUINET. Ky publikim është në dispozicion në faqen e internetit të KQZ-së në lidhje:
<http://cec.org.al/kryetari-i-kqz-se-zguri-takon-komisionerin-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi/>
11. Ka dërguar Rekomandimin 61 Bashkive të Republikës së Shqipërisë.
12. Ka dërguar Rekomandimin Avokatit të Popullit të Shqipërisë, me letër zyrtare dhe me postë elektronike, duke kërkuar gjithashtu, ta publikojnë në faqen e internetit dhe në mediat sociale. Avokati i Popullit publikoi të gjithë përmbajtjen e Rekomandimit në faqen zyrtare.
13. Ka dërguar Rekomandimin Komisionerit për të Drejtat e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me letër zyrtare dhe me email, duke kërkuar gjithashtu, brenda mundësive të tyre, ta botojnë atë në faqet e tyre të internetit dhe në median sociale.
14. Ka dërguar Rekomandimin Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, me qëllim shpërndarjen në shoqëri civile, duke u kërkuar atyre që ta publikojnë në faqen e tyre të internetit dhe t'ia shpërndajnë të gjitha organizatave të regjistruara të shoqërisë civile.

Të gjithë hapat e ndërmarra nga KMD, të sipër-cituar, janë publikuar në Buletinin e Equinet "Equinet at Work – May-July 2019", ku pasqyrohet veprimtaria e spikatur e Organeve të Barazisë për periudhën e raportuar.

Konkretisht, për periudhën Maj – Qershor 2019, në Seksionin e Rekomandimit dhe fushatës së promovimit të tij, thuhet se "Ne jemi mirënjohës për mbështetjen tuaj të gjerë për Rekomandim dhe fushatë, përfshirë këtu shpërndarjen shumë të plotë strategjike nga Komisioneri Shqiptar për Mbrojtjen nga Diskriminimi."

1.10.4 Pjesëmarrja nëgrupe pune ndërinstitutionale.

KMD është anëtar i Grupit Ndërinstitutional të Punës, në kuadër të kapitullit “Kriteri Politik” dhe Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, për të cilin institucion lider është Ministria e Drejtësisë.

KMD, anëtari Grupit Ndërinstitutional të Punës, në kuadër të Kapitullit 2 & 19, për të cilin institucion lider është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

KMD është institucioni përgjegjës për monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016 – 2020.

KMD është anëtar i Grupit Ndërinstitutional të Punës, në kuadër të Shqyrtimit të Raporteve Paraqitura nga Shtetet Palë, bazuar në Nenin nr.35 Të Konventës "Për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara".

KMD, ishte pjesë e Delegacionit Shqiptar, i cili mori pjesë në Sesionin e 33-të, të punimeve të Grupit të Punës, të Mekanizmit Universal Periodik (UPR), pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, të OKB-së, i cili u zhvillua në Gjenevë, më datë 6 maj, 2019. Në këtë takim u shqyrtua Raporti i Tretë Kombëtar për Shqipërinë, në kuadër të UPR-së. Mekanizmi UPR është një proces i rëndësishëm që përfshin shqyrtimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në vendet anëtare të OKB-së dhe detyrimin e shteteve palë mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

KMD, ka kontribuar në kuadër të ciklit të gjashtë monitorues për Shqipërinë, të realizuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI).

Në kuadër të Procesit *Screening*, KMD është angazhuar, përmes ekspertëve të tij, për plotësimin e tabelave, si vijon:

1. Analiza e boshlleqeve ligjore lidhur me Direktivën e Këshillit të Bashkimit Europian 2000/43/EC, datë 29 Korrik 2000 “Mbi implementimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht origjinës së tyre racore apo etnike”
2. Analiza e boshlleqeve ligjore lidhur me DIREKTIVEN NR. 113, datë 13 dhjetor 2004 “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas, në aksesin dhe për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve”.
3. Stukturat Administrative të kërkuara për zbatimin e legjislacionit Evropian që i përket Kapitullit 23.

1.10.5 Programi i transparencës

Në përputhje me programin e transparencës, KMD ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.kmd.al, vendimet për diskriminim dhe mosdiskriminim, nga ankesat individuale dhe ngahetimet kryesisht. Që nga shtatatori i vitit 2018 kemi pasur një rritje të kapacitetit të faqes nga AKSH-i dhe do publikohen edhe mospranimet e ankesave.

Në dispozicion të publikut në faqen zyrtare janë të gjitha rekomandimet e KMD-së dhe vendimet e Gjykatave. Gjithashtu, KMD, publikon në faqen zyrtare kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KMD-së dhe Zyrave Rajonale, orarin zyrtar.
- Funksionin dhe kompetencat e KMD
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë ankesë përdiskriminim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave.
- Kuadrin ligjor, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore. Raportet e KMD
- Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese të organizuara nga Zyra e KMD-së,
- Takimet e Komisionerit
- Marrëveshjet e bashkëpunimit
- Strukturën organizative të KMD-së;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, orarin e punës, emrin dhe kontaktete koordinatorit për të drejtën e informimit; regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të programit të transparencës.

Gjatë vitit 2019, në Programin e Transparencës pranë regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve janë regjistruar 47 kërkesa ku ju është dhënë përgjigje me shkresë ose me poste elektronike.

Në përgjithësi është kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e ankesave dhe tërheqjen e një kopje të dosjes së tyre. Ankuesit duan të dijnë gjithashtu nëse Vendimet e KMD janë ankimuar në Gjykatë.

Shoqata dhe qendra studimi kanë kërkuar informacione në lidhje me ankesat sipas shkaqeve të diskriminimit të fushës ku ato operojnë.

Zyrat Rajonale

1.11 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër

Në të gjitha aktivitetet ndërgjegjëse të zhvilluara gjatë vitit 2019, Komisioneri dhe Zyra Rajonale Shkodër kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si Ditët e Hapura kundër diskriminimit të organizuara nga Zyra Rajonale Shkodër, Pjesëmarrje në aktivitete bashkëpunuese, si dhe Dalje Publike në Media.

Gjithashtu, Zyra Rajonale Shkodër ka shpërndarë për njohje dhe informim më të zgjeruar, publikime të ndryshme, me fokus njohjen e institucionit të KMD, misionin dhe ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Janar

- Në 09 Janar 2019, u organizua një takim me Shkollën 9-vjeçare “Liria”, me qëllim inspektimin e shkollës lidhur me numrin e nxënësve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian që frekuntojnë këtë shkollë. Nga ky inspektim rezultoi se pjesa më e madhe e nxënësve të kësaj shkolle i përket komunitetit Rom.
- Në 09 Janar, u organizua një takim me përfaqësues të organizatës “Për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian”, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve rome dhe egjiptiane, sensibilizimin e komunitetit në edukimin dhe shkollimin e brezit të ri, si dhe zhvillimin e aktiviteteve social-kulturor, që promovojnë vlerat e komuniteteve rome dhe egjiptiane, në rajonin e Shkodrës e më gjerë.
- Në 14 Janar, u organizua një takim me përfaqësues të fondacionit “Ana-Zëri i Shpresës”. Ky takim u realizua në qendrën për “Personat me Aftësi Nryshe”, krijuar nga ky fondacion. Në takim u diskutua me psikologun e qendrës lidhur me problematikat diskriminuese që ato mund të kenë hasur gjatë punës të tyre, si dhe me problematikat e hasura nga prinderit e personave me aftësi ndryshe në lidhje me diskriminimin.
- Në 17 Janar 2019, u organizua një takim në ambientet e zyrës rajonale me përfaqësues të qendrës “Ndihma Ligjore Falas” dhe avokatin e kësaj qendre z. Blendi Dibra. Ky takim kishte si qëllim promovimin e kësaj zyre, si dhe bashkëpunimin ndërmjet Zyrës Rajonale dhe qendrës “Ndihma Ligjore Falas”.
- Në 18 Janar 2019, u organizua një takim me kryetarin e shoqatës “Moraça-Rozafa” z. Pavlo Jakoja. Në këtë takim u diskutua rreth problematikave që kjo pakicë është ndeshur ndër vite.
- Në 24 Janar 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në një takim të realizuar nga “Karitasi Dioqezan i Sapës” në bashkëpunim me Fondacionin

Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar” në Bashkinë Vau-Dejës, me temë “Vlerësimi i Shërbimeve të Punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuar”.

- Në 29 Janar 2019, u organizua një takim me përfaqësuesin e “Nismës Vullnetare Studentore”. Në këtë takim u diskutua rreth një bashkëpunimi të mundshëm për ndërmarrjen e nismave të përbashkëta sa i përket mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Shkurt

- Në 08 Shkurt 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në takimin e organizuar nga shoqata shkodrane e “Invalidëve të Punës Para-Tetraplegjikë të Lindur dhe të Aksidentuar Gjatë Jetës” në bashkëpunim me organizatën “Uniteti Global Alban”, me temë “Problematikat e Personave me Aftësi të Kufizuar”.
- Në 12 Shkurt 2019, u organizua takim me përfaqësuesen e “World Vision” në Shkodër znj.Valbona Doçi lidhur me bashkëpunimin me Zyrën Rajonale Shkodër.
- Në 16 Shkurt 2019, Zyra Rajonale Shkodër, ka marrë pjesë në trajnimin me temë: “Roli i Mardhënieve Atashuese në Përjetimin e Emocioneve tek Personat me Aftësi të Kufizuar”. Ky trajnim u organizua nga Fondacioni “Anna” në bashkëpunim me shoqaten “Gruaja në Zhvillim Shkodër”.

Mars

- Në 01 Mars 2019, u organizua trajnimi me temë “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi për Shkak të Gjinisë” në bashkëpunim me Fondacionin Anna.
- Në 01 Mars 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka dhënë një intervistë për median lokale “Antena TV” , në përfundim të trajnimit të realizuar nga Fondacioni “Anna”.
- Në 06 Mars 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në aktivitetin e hapjes dhe prezantimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve Llogaridhëse nga Institucionet Lokale” në Shkodër kundrejt komuniteteve Rome dhe Egjiptiane që implementohet nga shoqata “Qendra e Këshillimeve dhe Shërbimeve Psikologjike”.
- Në 11 Mars 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” me temë “Më dëgjo edhe mua”. Aktiviteti ishte sensibilizues, kundër dhunës me bazë gjinore.
- Në 11 Mars 2019, u zhvillua takimi informues me prindër dhe nxënës në shkollën speciale “3-Dhjetori” në bashkëpunim me zyrën e Shërbimeve Ligjore Falas.
- Në 29 Mars 2019, u organizua trajnimi me pjesëmarrës nga komuniteti Rom dhe Egjiptian në kuadër të projektit “Dëgjoje Zërin tim”, të implementuar nga “Shoqata Intelektualët e Rinj, Shpresë”.

Prill

- Në 12 Prill 2019 specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka qënë ftuar në emisionin e mëngjesit në median lokale “Antena Tv” për të folur rreth temës së “Gjuhës së urrejtjes online”.
- Në 16 Prill 2019, takime pune i Komisionerit në shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe përfaqësuesit e shoqatës “Për të drejtat e komunitetit Rom dhe Egjiptian”, ku u diskutua çështja e segregimit të nxënësve, ngritur pranë Zyrës së KMD. Takimi vijoi më tej në qendrën komunitare në lagjen “Iliria”, me përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian (25 vetë), ku u dëgjuan nevojat e këtij komunitetit në lidhje me edukimin dhe shërbimet. Takimi i fundit, po këtë ditë u zhvillua me organizatat e shoqërisë civile në qytetin e Shkodrës, me të cilët u diskutuan sfidat e komunitetit për çështje që lidhen me diskriminimin. Në këtë takim morën pjesë 23 përfaqësues të organizatave.
- Në 18 Prill 2019, u zhvillua takim informues në bashkëpunim me shoqatën “Shpresa për të Ardhmen”.
- Në 23 Prill 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Projekti Shpresa” në kuadër të ditës ndërkombëtare të librit me temë: “Libriopsikosinteza”.

Maj

- Në 08 Maj 2019, Zyra Rajonale Shkodër, në bashkëpunim me “Qendrën e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike” realizoi një trajnim në ambientet e kësaj qendre ku të pranishëm ishin anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Në 09 Maj 2019, Zyra Rajonale Shkodër, ka pritur në zyrë përfaqësuesit e OSCE. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e OSCE u njohën me funksionet dhe detyrat e Zyrës Rajonale Shkodër si dhe me aktivitetet e realizuara nga kjo zyrë.
- Në 10 Maj 2019, u zhvillua aktivitet sensibilizues në shkollën 9-vjeçare “Xheladin Fishta” me temë “Të gjithë jemi të ndryshëm, por të barabartë”. Ky aktivitet kishte si qëllim ndërgjegjsimin e nxënësve, për pranimin dhe mbështetjen e bashkëmoshatarëve të tyre me aftësi ndryshe.
- Në 13 Maj 2019 specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në aktivitetin promovues të projektit “Një Portë e Hapur”, faza 2, mbështetur nga GIZ ProSEED Albania, implementuar në Shkodër nga shoqata “Shpresa për të Ardhmen”.
- Në 15 Maj 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në aktivitetin social me temë “Disiplina në Rutinën Ditore të Shtëpisë Familje”, në kuadër të Ditës Botërore të Familjes. Ky aktivitet u përqëndrua kryesisht në temën “Diskriminimi si një Ndikues Negativ në Arritjen e Lumturisë në Familje”.
- Në 17 Maj 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në takimin me temë “E Drejta e Punës Përmes Shprehjes së Veprimit” në kuadër të projektit “Të

Rinjtë për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri ”, që implementohet në Shkodër nga shoqata *“Gruaja në Integrim”*.

- Në 19 Maj 2019, në bashkëpunim me shoqatën *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”*, u realizua forumi civil me të rinjtë e shkollës *“Prenke Jakova”* në qytetin e Shkodrës dhe shkollës *“Frederik Gjoni”*, njësia administrative Bërdicë, në kuader të projektit *“Raise Your Voice for Human Rights”*, implementuar në Shkodër, nga kjo shoqatë.
- Në 20 Maj 2019, Zyra Rajonale Shkodër, organizoi takim me kordinatorin e qendrës sociale *“Hapa të Lehtë”* Shkodër, znj. Denada Shpuza.
- Në 23 Maj 2019, u organizua një takim me Bashkinë Malësi e Madhe, konkretisht në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale të kësaj Bashkie.
- Në 24 Maj 2019, u realizua një sesioni informues në shkollën *“Frederik Gjoni”* njësia administrative Bërdicë, Bashkia Shkodër.
- Në 29 Maj 2019, Zyra Rajonale Shkodër në bashkëpunim me Rektoratin e Universitetit *“Luigj Gurakuqi”*, organizoi një leksion të hapur informues e ndërgjegjësues me studentë të këtij universiteti. Leksioni u mbajt nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda.

Qershor

- Në 06 Qershor 2019, në bashkëpunim me shoqatën *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”*, në njësinë administrative Gur i Zi, Bashkia Shkodër, u realizua forumi civil, në kuadër të projektit *“Raise Your Voice for Human Rights”*, të implementuar nga kjo shoqatë.
- Në 08 Qershor 2019, u organizua një takim me përfaqësuesit e shoqatës *“Intelektualët e Rinjë Shpresë”*, për zbatimin e projektit *“Të Rinjtë për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri”*.
- Në 10 Qershor, u organizua një takim me përfaqësuesit e shoqatës *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”* për përcaktimin e axhendës së trajnimeve në kuader të projektit *“Raise your voice for human rights”*.
- Në 14 Qershor 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në takimin e realizuar nga organizata *“People in Focus”*, me temë *“Shërbimet Administrative Gjyqësore në Gjykatat Shkodër”* pjesë e skemës së granteve të projektit *“Përfshirja e Shoqërisë Civile për një Sistem Drejtësie Funkcional dhe të Barabartë për të Gjithë në Shqipëri”*.
- Në 18 Qershor 2019, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër, mori pjesë në aktivitetin social të organizuar nga *“Parlamenti Rinor Shkodër”*, aktivitet i cili kishte si qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve nëpërmjet shfaqjes së një filmi social, për pranimin dhe respektimin e bashkëmoshatarëve të tyre me aftësi ndryshe.
- Në 20 Qershor 2019, në bashkëpunim me shoqatën *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”*, në njësinë administrative Dajç, u realizua forumi civil, në kuadër të

projektit *“Raise Your Voice for Human Rights”*, implementuar në Shkodër, nga kjo shoqatë.

- Në 24 Qershor 2019, u organizua një takim me përfaqësuesen e *“Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Para- Tetraplegjikë”* të lindur dhe të aksidentuar gjatë jetës, qëllimi i takimit ishte organizimi në ditët në vazhdim të një takimi me antarë të kësaj shoqate dhe diskutimin e problematikave që kanë personat me aftësi të kufizuara.
- Në 27 Qershor 2019, në bashkëpunim me shoqatën *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”*, në njësinë administrative Ana e Malit, Bashkia Shkodër, u realizua forumin civil, në kuadër të projektit *“Raise Your Voice for Human Rights”*, të implementuar në Shkodër nga kjo shoqatë.

Korrik

- Më 2 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me përfaqësuesit e shoqatës *“Intelektualët e Rinjë Shpresë”*, për përcaktimin e axhendës për trajnimin me temë *“Barazia dhe mosdiskriminimi”*.
- Më 3 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim në qendrën komunitare për familjen nr.5, me përgjegjësen e kësaj qendre. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i rastit Diamanta Bajrami. Lidhur me këtë rast ka telefonuar dhe përfaqësuesen e qendrës komunitare për familjen nr.4.
- Më 13 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në aktivitetin social në *“Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç”*, të organizuar nga organizata Intelektualët e Rinjë Shpresë.
- Më 22 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me znj. Gjina Ndou përfaqësuese e *“Shoqatës Shkodrane të Personave Para-Tetraplegjikë të Lindur dhe të Aksidentuar Gjatë Jetës”*. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i vendimit të KMD-së kundër Bashkisë Shkodër në kuadër të ankesës së inicuar nga kjo organizatë.

Gusht

- Më 8 Gusht, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me juristin e Ujësjellës Kanalizime Shkodër, lidhur me shkresën Nr.644/5 e datës 24.07.2019 e KMD drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Ujësjellës Kanalizime Shkodër.
- Më 13 Gusht, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Bashkia Shkodër, lidhur me shkresën Nr.644/5 e datës 24.07.2019 e KMD drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

Shtator

- Më 9 Shtator, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me znj. Silvana Marku anëtare e grupit zbatues të projektit “Të ndihmojmë për njohjen dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për ndihmen juridike të garantuar nga Shteti”, projekt i cili po realizohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Qëllimi i takimit ishte informimi lidhur me shkaqet për të cilat ka pasur më shumë rastë dhe ankesa në Zyrën Rajonale të KMD-së Shkodër.
- Më 11 Shtator, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar takim me znj. Gjina Ndou përfaqësuese e “Shoqatës Shkodrane për personat para dhe tetraplegjikë të lindur dhe të aksidentuar gjatë jetës”, lidhur me problematiken e shërbimit urban i cili duhet të ofrohet falas për personat me aftësi të kufizuar.
- Më 16 Shtator, Zyra Rajonale Shkodër, ka organizuar një trajnim me temë: “Të njohim dhe të zbatojmë të drejtat ndërkombëtare të njeriut” në bashkëpunim me “Intelektualët e Rinjë Shpresë”, në kuader të projektit “Raise Your Voice for Human Rights” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Ëorl Vision dhe SEEYN (South East European Youth Network). Në këtë takim morën pjesë 15 persona nga të cilët 2 mësuese, 6 nxënës dhe 7 studentë.
- Më 17 Shtator, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë, në takimin e organizuar në formën e një seance orientuese mbi “Të drejten për jetesë të pavarur për personat me aftësi ndryshe” e organizuar nga shoqata “Ndihmoni Jetën” në bashkëpunim me “Projektin Shpresa”.
- Më 18 Shtator, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me përgjegjësen e Shërbimit Social në Bashkinë Malësi e Madhe znj. Ilda Rexhaj. Qëllimi i takimit ishte, realizimi i një trajnimi lidhur me temë “Barazia dhe Mosdiskriminimi” me personat në nevojë dhe stafin e punojësve të shërbimit social në Bashkinë Malësi e Madhe.
- Më 19 Shtator, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar një “Forum Civil” në njësinë administrative Postribë, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me shoqatën “Intelektualët e Rinjë Shpresë”, në kuader të projektit “Raise Your Voice for Human Rights” të implementuar në Shkodër nga shoqata “Intelektualët e Rinjë Shpresë”. Në këtë takim morën pjesë 17 persona nga të cilët 15 nxënës, 1 punojës social, 1 mësues.
- Më datë 23 Shtator, Zyra Rajonale Shkodër, ka organizuar një trajnim me temë: “Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Barazia dhe Mosdiskriminimi” në bashkëpunim me shoqatën “Intelektualët e Rinjë, Shpresë”, në kuader të projektit “Raise your voice for human rights”, mështetur nga Ëorl Vision. Në këtë trajnim morën pjesë 15 studentë.
- Më 27 Shtator, Zyra Rajonale Shkodër, ka realizuar në shkollën “Kolë Idromeno” Shkodër një “Forum Civil”, me nxënësit e kësaj shkolle në bashkëpunim me shoqatën “Intelektualët e Rinjë, Shpresë”, në kuader të

projektit “Raise your voice for human rights”, mështetur nga Eorld Vision. Në këtë takim morën pjesë 17 nxënës.

Tetor

- Më 2 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër, ka organizuar në bashkëpunim me qëndren “Streha” në qytetin e Shkodrës një Eorkshop me temë: “Njohja e të drejtave të njeriut dhe adresimi i tyre”. Në këtë takim morën pjesë 22 persona me probleme të ndryshme sociale.
- Më 3 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Shkodër znj. Rozafa Zmijani. Tema e takimit ishte “Problematikat e punësimit të komunitetit Rom”.
- Më 7 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional, Shkodër znj. Megi Markiqi. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi ndërinstitutional.
- Më 8 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka bërë të mundur vendosjen e posterit informues të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shkollën “At Gjon Karma”, njësisia administrative Gur i Zi Bashkia Shkodër.
- Më 9 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër, ka realizuar një takim me drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër znj. Vjoleta Staka, qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi.
- Më 10 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër në kuader të “Ditës Ndërkombëtare të Shëndetit Mendor” u realizua një takim në qëndren e fondacionit “Ana Zëri i Shpresës”, me personat me aftësi ndryshe që frekuentojnë këtë qëndër ditore.
- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar takime të vazhdueshme me znj. Gjina Ndou përfaqësuese e “Shoqatës Shkodrane për personat para dhe tetraplegjikë të lindur dhe të aksidentuar gjatë jetës”, lidhur me problematiken e shërbimit urban i cili duhet të ofrohet falas për personat me aftësi të kufizuara.
- Më 14 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional një sesion informimi, mbi mbrojtjen që ofron Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në fushën e punësimit me kursantë që ndjekin kurset profesionale falas pranë kësaj drejtorie. Në këtë takim morën pjesë 28 persona.
- Më 16 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me përgjegjësen e Shërbimit Social, Bashkia Malësi e Madhe, një trajnim me punojës social të kësaj Bashkie. Qëllimi i këtij takimi ishte informimi dhe trajnimi i punojësve socialë lidhur me evidentimin e rasteve të diskriminimit dhe mënyrën e referimit të tyre pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë takim morën pjesë 8 punonjës social.
- Më 18 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në kuader të Javës Ndërkombëtare të Sportit në bashkëpunim me “Intelektualët e Rinjë Shpresë”

, një sesion informues me pjesëmarrjen si të ftuar të basketbollistit me ngjyrë Hudson, i cili është pjesë e Klubit Sportiv Vllaznia, ky sesion informues kishte si qëllim të bashkojë dhe të sensibilizojë mbështetësit, klubet, lojtarët, grupet e pakicave dhe komunitetet e prekura nga diskriminimi për të kërkuar barazi dhe gjithë përfshirje. Në këtë takim morën pjesë 10 persona.

- Më 16 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me drejtuesen e Zyrës Vendore Arsimore Malësi e Madhe.
- Më 17 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër, ka realizuar në Shkollën 9 vjeçare “Edith Durham”, Shkodër një takim me temë: “Të ndryshëm por të barabartë”, në formën e diskutimit të hapur me nxënësit. Në këtë takim morën pjesë 25 nxënës të cilët u informuan gjithashtu për mbrojtjen që ofron ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Më 18 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me drejtuesin e ADISA Shkodër z. Mirsad Sylja. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mënyrës së zhvendosjes së Zyrës Rajonale në ambientet e ADISA Shkodër.
- Më 19 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me fondacionin “Anna, Zëri i Shpresës” një trajnim me temë: “Të njohim dhe të mbrojmë të drejtat e fëmijëve”. Trajnimi kishte si qëllim njohjen me të drejtat e fëmijëve dhe mënyrën se si mund ti mbrojmë ata. Diskriminimin dhe bulizmi tek fëmijët, si mund ti evidentojmë rastet dhe ku mund ti adresojmë. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 14 persona që punojnë në arsim dhe psikologë.
- Më 23 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër, ka realizuar në Shkollën e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër një takim në formën e diskutimit të hapur me nxënësit. Në këtë takim morën pjesë 19 nxënës të cilët, gjithashtu u informuan për mbrojtjen që ofron ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Më 28 Tetor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me “Intelektualët e Rinjë Shpresë”, trajnime temë: “Të njohim dhe të zbatojmë të drejtat ndërkombëtare të njeriut”, në kuader të projektit “Raise Your Voice for Human Rights” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga World Vision dhe SEEYN (South East European Youth Network). Në këtë trajnim morën pjesë 15 persona nga të cilët 9 studentë dhe 6 nxënës.
- Më 30 Tetor, ka realizuar një takim me drejtuesin e Operatorit të Kujdesit të Shëndetit Publik, Shkodër z. Astrit Beci. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi ndër-institucional.

Nëntor

- Më 4, 13 dhe 18 Nëntor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me “Intelektualët e Rinjë Shpresë” trajnime me temë: “Të njohim dhe të zbatojmë të drejtat ndërkombëtare të njeriut”, në kuadër të projektit “Raise

Your Voice for Human Rights” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Eorld Vision dhe SEEYN (South East European Youth Netëork). Në secilin prej këtyre trajnimeve kanë marrë pjesë në total 45 persona ku nga këto 3 punojëse sociale, 15 nxënës, 18 studentë, 9 të tjerë.

- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër takime të vazhdueshme me organizatën “Intelektualët e Rijnë, Shpresë”, këto takime kishin si qëllim diskutimin rreth aktiviteteve të përbashkëta që janë realizuar.
- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër takime të vazhdueshme me shoqatën e “Invalidëve të punës”, takimet kishin si qëllim diskutimin e problematikave që ndeshen invalidët e punës dhe referimin e rasteve pranë Zyrës Rajonale Shkodër të KMD.
- Më 14 Nëntor, ka realizuar një takim me përgjegjësen e Shërbimit Social Bashkia Vau-Dejës Znj.Qukë Babani.
- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër takime dhe komunikime të herëpashershme me kryetarin e shoqatës së personave para-tetraplegjikë Shkoder z. Saimir Beqiri për diskutimin e problematikave konkrete.
- Më 21 Nëntor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë, në takimin e organizuar nga organizata Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në qytetin e Shkodrës në formën e një tryeze diskutimi me temë:“Njohja dhe zbatimi i ligjit për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në kuadrin e konsolidimit të Shtetit të së Drejtës”.
- Më 22 Nëntor, Zyra Rajonale Shkodër ka organizuar në bashkëpunim me “Qëndrën për Nisma Ligjore Qytetare” një aktivitet ndërgjegjësues me temë:“Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi të drejtat ligjore dhe aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë”, si dhe prezantimi me zyrën që ofron ndihmë ligjore falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkoder. Pjesëmarrës në këtë takim ishin 26 persona, persona në nevojë 5, studentë 12, përfaqësues të institucioneve 4 dhe organizatave 5.
- Më 25 Nëntor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në aktivitetin sensibilizues të realizuar nga organizata “Gruaja tek Gruaja” dhe “Zyra për Djem dhe Burra” me temë:“Koha ime është tani”. Ky aktivitet u organizua në kuader të hapjes së fushatës të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.Aktiviteti ishte i organizuar në formën e një shfaqjeje sensibilizuese në sheshin "Luigj Gurakuqi".

Dhjetor

- Më 3 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Projekti Shpresa” me temë:“Jetesë e pavarur ëndërr apo realitet për personat me aftësi të kufizuara”.Ky aktivitet ishte i organizuar në formën e një forumi social për të diskutuar temën në fjalë. Në

këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve lokale në Shkodër, përfaqësues të organizatave dhe persona me aftësi ndryshe.

- Më 4 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me drejtoreshën e Zyrës Vendore Arsimore Shkodër znj. Blediana Osja. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi lidhur me aktivitetet që KMD realizon në shkolla.
- Më 10 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në aktivitetin me temë: "Mbi mbështetjen e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe përdorimin e Konventës së Stambollit dhe rekomandimeve të GREVIOs si mjet ndryshimi", të organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në Tiranë. Ky aktivitet u realizua në kuader të projektit "Ngritja e një rrjeti të organizatave jo fitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri", zbatuar nga QNL. Projekti financohet nga Komisioni Europian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.
- Më 11 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë, në sesionin informues të organizuar nga "Intelektualët e Rinjë, Shpresë" me temë "Drejtësia penale për të mitur". Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Second chance" i cili zbatohet nga "Shoqata Intelektualet e Rinjë, Shprese" në kuader të skemës së granteve të vogla të projektit "Aktivizimi i Shoqërisë Civile në Modelimin e Praktikave Restauruese për Fëmijët dhe të Rinjtë në Kontakt me Ligjin" i financuar nga Bashkimi Europian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri. Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të grupeve të interesit lidhur me zbatimin e këtij projekti.
- Më 17 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër realizoi një takim bashkëpunimi me përfaqësuesen e Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër znj. Xhevahire Halili. Qëllimi i takimit ishte mundësia e referimit të ndërsjelltë të rasteve ndërmjet dy zyrave. Ndërmjet zyrave ka pasur referim të rasteve konkrete gjatë kësaj periudhe.
- Më 18 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë, në sesionin informues për "Legjislacionin penal për të mitur", në kuader të projektit "Second chance" që zbatohet në qytetin e Shkodrës nga shoqata "Intelektualët e Rinj, Shpresë" në shkollën e mesme profesionale "Hamdi Bushati" me nxënës të kësaj shkolle.
- Më 20 Dhjetor, Zyra Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me studentë të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në ambjentet e Zyrës Rajonale Shkodër. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i studentëve me Zyrën Rajonale Shkodër, rolin dhe funksionet e saj, si dhe shërbimet që kjo zyrë realizon. Takimi gjithashtu kishte si qëllim nxitjen e të rinjve në përfshirjen në aktivitetet që Zyra Rajonale Shkodër realizon. Në takim morën pjesë 6 studentë.

- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër takime të herë pas herë me krytarin e shoqatës “Për të drejtat e komunitetit Egjiptian” z. Kudret Shatza. Qëllimi i takimeve ka qënë diskutimi i problematikave që shqetësojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian si dhe diskutimi rreth problematikave të adresuara në ankesën drejtuar KMD.
- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka bashkëpunuar dhe komunikuar me organizata si qendra “Streha”, Tiranë, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, sa i përket realizimit të aktiviteteve të përbashkëta në qytetin e Shkodrës me qëllim zgjerimin e rrethit të organizatave me të cilat Zyra Rajonale Shkodër bashkëpunon.

Në të gjitha aktivitetet ndërgjegjëse të zhvilluara gjatë këtij viti, Zyra Rajonale Shkodër ka shpërndarë për njohje dhe informim më të zgjeruar, publikime të ndryshme, me fokus njohjen e institucionit të KMD, misionin dhe ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Dalje në media

Zyra Rajonale Shkodër e shikon bashkëpunimin me median si një mjet i rëndësishëm në përcimin e informacionit dhe promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të parandotuar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në këtë kuader ka realizuar këto dalje në median lokale:

- Më 1 Mars, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka dhënë një intervistë për median lokale “Antena TV”, në përfundim të trajnimit të realizuar nga Fondacioni “Anna”.
- Më 12 Prill, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka qënë e ftuar në emisionin e mëngjesit në median lokale “Antena Tv” për të folur rreth temës së “Gjuhës së urrejtjes online”.
- Më 17 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka dhënë një intervistë për median Lokale “TV1Chanel”. Qëllimi i intervistes ishte evidentimi i shkaqëve për të cilat ka të cilat ka pasur më shumë ankesa në Zyrën Rajonale Shkodër.
- Më 19 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë në median lokale Antena TV, Shkodër lidhur me trajnimin me temë: “Të njohim dhe të mbrojmë të drejtat e fëmijëve”, të realizuar në bashkëpunim me “Fondacionin Ana”.
- Më 29 Korrik, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë për televizionin lokal “Star Plus” lidhur me ankesat që kanë ardhur në Zyrën Rajonale Shkodër.
- Më 18 Tetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë në median lokale Rozafa TV, në kuadër të “Javës Ndërkombëtare të Sportit”,

lidhur me sesionin informues për “Mosdiskriminimin në Sport” të realizuar në bashkëpunim me IRSH.

- Më 13 Nëntor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë me temë "Diskriminimi në punë" në median lokale TV1 Chanel , Shkodër.
- Më 18 Dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë në median locale Star Plus TV, në kuader të mbydhjes së projektit "Raise your voice for human rights", ku Zyra Rajonale Shkodër ka qënë partnere në zbatimin e këtij projekti nga shoqata IRSH në qytetin e Shkodrës.

1.12 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik, është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar Zyra Rajonale Korçë ka organizuar gjatë kësaj periudhe takime informuese me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, komunitet, organizim i ditëve të hapura ku në fokus ka patur rritjen e rolit të bashkëpunimit ndërmjet tyre si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim. Gjatë takimeve janë shpërndarë edhe materjale promovuese.

Janar

- Në 12 Janar 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin me temë “Ngritja e Rrjetit të Organizatave dhe Institucioneve që Mbrojnë të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”, zhvilluar nga shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar” (MEDPAK).

Shkurt

- Në 22 Shkurt 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin për prezantimin e draft raportit për monitorimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar”, në nivel lokal, për qytetin e Korçës.

Prill

- Në 1 Prill 2019, Zyra Rajonale Korçë organizoi një takim me përfaqësues të OJF dhe komunitetit në Pogradec, në ambjentet e Qendrës Multifunksionale. Takimi kishte në fokus problematikat social-ekonomike të komunitetit rom dhe egjiptin dhe personave me aftësi të kufizuar, prezantimi i punës së Komisionerit për zgjidhjen e çështjeve që vijnë nga këto komunitete.

- Më datën 8 prill 2019, në Ditën Ndërkombëtare të Romëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda, ishte i pranishëm në takim që komuniteti rom dhe OJF-të rome kishin organizuar, në simbol të kësaj dite. Takimi ishte i hapur me pjesëmarrje të gjërë siç ishin presidenti i romëve të Ballkanit, pedagogë të universitetit “Fan S. Noli” , përfaqësues të shoqërisë civile, avokatë etj. Në përfundim të aktivitetit, organizatat rome dhe egjiptiane që operojnë në qytetin e Korçës nënshkruan marrëveshjen e krijimit të rrjetit të përbashkët të bashkëpunimit mes tyre.
- Në 16 Prill 2019, Zyra Rajonale Korçë organizoi një takim me një grup nënash të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në fokus të takimit ishte adresimi i rasteve pranë KMD, për problematika të ndryshme, siç janë vendosja e mësuesve mbështetës në shkolla.
- Në 19 Prill 2019, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga World Vision Albania (WVA), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE), në kuadër të projektit *"Forcimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për Zbatimin e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri"*, në partneritet me Fondacionin *"Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara"* (FSHDPAK) dhe Shoqatën për *"Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara"* (MEDPAK). Prezantimi i gjetjeve të raportit, të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Aftësisë së Kufizuar (2016-2020) nga këndvështrimi i shoqërisë civile në Korçë.
- Në 23 Prill 2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda dhe z. Roberto De Bernardi, përfaqësuesi i UNICEF në Shqipëri, vizituan shkollën 9- vjeçare “Ismail Qemali” dhe zhvilluan një takim të hapur me mësues, nxënës dhe prindër të kësaj shkolle. Në takim u adresuan çështje të tilla si bullizmi, përjashtimi i fëmijëve nga edukimi dhe gjetja e instrumenteve për të ndërtuar bashkëpunimin, shkollë-komunitet-institucione. Në kuadër të mbështetjes që Unicef i ka dhënë Zyrës Rajonale Korçë, përfaqësuesi i UNICEF, i shoqëruar nga Komisioneri, z. Gajda, vizituan ambientin e ri të kësaj zyre dhe siguruan vijueshmërinë e suksesshme të bashkëpunimit mes dy institucioneve.
- Në 24 Prill 2019, ka marrë pjesë në prezantimin e dy qendrave lëvizëse multifunksionale që do të jenë në Korçë, mbështetur nga TDH (*"TERE DES HOMES"* Organizatë Ndërkombëtare që punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve), Bashkia Korçë dhe Misioni “Emanuel”.
- Në 25 Prill 2019, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga ROMACTED dhe Bashkia Korçë, me përfaqësues të institucioneve, OJF-ve, për prezantimin i draftit të parë të *"Planit Vendor të Veprimit për Intergrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane 2019 – 2022"*.
- Në 26 Prill, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga UN Women dhe Bashkia Korçë mbi raportin dhe prezantimin e gjetjeve për ngacmimin seksual

dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri, mbështetur nga UNDP, UN WOMEN dhe IDRA.

Maj

- Në 3 Maj 2019, ka marrë pjesë në takimin e organizuar në kuadër të projektit ROMACTED me nën/kryetaren e Bashkisë znj. Benila Themeli.
- Në 6 Maj 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin përmbyllës për prezantimin e raportit mbi *"Funksionimin e Mekanizmave të Qeverisjes Komunitare për Pjesëmarrjen Qytetare"*, organizuar nga *"Lëviz Albania"* dhe shoqata *"Gruaja në Zhvillim"*.
- Në 7 Maj 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin me temë *"Qeverisja Komunitare - Sfidat e Funksionimit të Mekanizmave për Pjesëmarrjen në Vendimarrjen Qytetare"*, organizuar nga Bashkia Korçë.
- 7 Maj 2019, Zyra Rajonale Korçë organizoi *"Ditën e Hapur"* me banorë të zonës së njohur si *"Gjeologjikja"*. Banorët sollën shqetësimin e tyre në lidhje me strehimin dhe ndërhyrjen e bashkisë për rregullimin e banesave ekzistuese. Banorët u informuan mbi presencën e Zyrës Rajonale të KMD në qytetin e Korçës, mbi misionin dhe rolin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe parashtrimin e çdo problematike diskriminuese, me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e mundshme të tyre.
- Në 8 Maj 2019, ka marrë pjesë në prezantimin e raportit të *"Gjetjeve për Personat me Aftësi të Kufizuar"*, organizuar nga Bashkia e Korçë.
- Në 9 Maj 2019, ka marrë pjesë në takimin me studentët dhe përfaqësues të institucioneve publike, ku u bë prezantimi për shërbimet që ofron çdo institucion publik. Takimi u zhvillua nga IRCA në kuadër të pojektit ROMACT.
- Në 10 Maj 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin me temë *"Politikat e Qeverisjes Lokale dhe Problematikat e Shoqërisë"* zhvilluar nga BIRN, në lidhje me problematikat që kanë Bashkitë e Qytetit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.
- Në 13-14 Maj 2019, Zyra Rajonale Korçë organizoi një takim me banorët e ish-konviktit të Bujqësorës dhe Ndërtimit. Banorët shprehen shqetësimin për kushtet e vështira të banimit si dhe të papunësisë.
- Në 16 Maj 2019, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga shoqata *"Qendra Europiane"* me temë *"Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut"*, faktorët që ndikojnë në diskriminim dhe rrugët për zgjidhjen e tyre.
- Në 22 Maj 2019, ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar nga Bashkia Korçë me përfaqësues të Këshillit European Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), të cilët u njohën nga afër dhe diskutuan për vizionin dhe projektet e tjera, që do të realizohen në mbështetje të komunitetit rom dhe egjiptian në Korçë.

Qershor

- Në 14 Qershor 2019, ka marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Shëndetësisë dhe UNDP me temë “Monitorimi i Planit të Veprimit për 2016-2020”.
- Në 18 Qershor 2019, ka marrë pjesë në prezantimin e “Raportit të Monitorimit” të Bashkisë, i cili kishte si qëllim informimin e qytetarëve, në lidhje me gjithë veprimtarinë e Bashkisë në fusha të ndryshme. Në takim merrnin pjesë përfaqësues të Shoqërisë Civile, institucione e OJF të ndryshme.
- Në 21 Qershor 2019, Zyra Rajonale Korçë organizoi një takim informues dhe ndërgjegjësues, me një grup nënash të komunitetit rom dhe egjiptian. Në takim u diskutuan problematikat social-ekonomike dhe adresimi i rasteve të diskriminimit, pranë KMD.

Korrik

- Më datën 2 korrik është organizuar takimi me 15 banorët e ish Gurit të Kuq të cilët janë informuar për procesin gjyqësor që po ndodh, ku specialistja e KMD është prezent në këto seanca për të parë ecurinë e procesit.
- Më 5 korrik, takim me nën/kryetarin e Bashkisë lidhur me rastin e banorëve të ish konviktit të bujqësorës. Problematikë ka qënë ndërprerja e ujit të pijshëm, energjia, kushte të papërshtatshme banimi si dhe mundësia e zhvendosjes së këtyre familjeve mbasi ata jetojnë në kushte tepër të vështira.
- Më datën 16 korrik është zhvilluar takim informues me 10 banorët e konviktit të ndërtimit ku gjatë bisedës ata janë njohur me ekzistencën e KMD si dhe kanë shprehur problematikat e ndryshme social ekonomike të cilat ata i shohin si diskriminim nga ana e institucionve mbasi nuk marin tek këta të fundit shërbimin e duhur.
- Më 17 korrik, pjesëmarrëse në takimin e zhvilluar nga “Linja e këshillimit për gra dhe vajza” në bashkëpunim me Bashkinë Korçë organizuan takimin me temë “Shërbimet që ofron linja për viktimat e dhunës në familje”.
- Më 23 korrik pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga shoqata e prindërve me aftësi të kufizuar.
- Më 29 korrik takim informues me studentët. Takimi u zhvillua në ambjentet e Qendrës Rinore Korçë ku këta të fundit u njohën me ligjin kundër diskriminimit, problematikat që hasin të rinjtë në ditët e sotme si dhe u ofrua informacioni në lidhje me formularin e ankesës nëse ata pretendojnë që janë të diskriminuar.

Shtator

- Gjatë muajit shtator, specialistja e Zyrës Rajonale Korçë ka organizuar një takim institucional me specialisten e zyrës së strehimit Pogradec për rastin e banorëve

të Gurit të Kuq, organizuar disa takime për të gjetur mundësinë për zgjidhjen e këtyre problematikave.

- Më 3 shtator, takim me përfaqësues të organizatave Rome dhe Egjiptjane lidhur me shqetësimet që ata kanë për problematikën e arsimimit parashkollor-universitar.
- Më dt 18 shtator 2019 takim me banorët e lagjes 8 të qytetit. Tema "Informim mbi ekzistencën e zyrës së KMD". Rolin e saj për mbrojtjen nga diskriminimi, informacion në lidhje me mbushjen e një ankese etj.

Tetor

- Më 5 tetor Pjesëmarrje në Workshop me temë: "Njohja e të drejtave të njeriut dhe adresimi i tyre", organizuar nga Qendra "Streha".
- Më 7 tetor, takim institucional. Zyra Rajonale me drejtoreshën e shkollës së mesme themistokli Gërmenji. Organizim takimi informues me nxenesit stafin për KMD.
- Më 9 tetor Pjesëmarrje në aktivitet organizuar nga IRCA në bashkëpunim me Qendren Rinore. Tema: "Përfshirja e minoritetve dhe grupeve në nevojë në vendimarrje". Pjesëmarrës
- Më 9 tetor takim me drejtorin e ZA Korçë. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë me ZVA në Rajonin e Korçës dhe më gjerë.
- Më 10 tetor 2019 takim me OJF R/E. Takimi kishte në fokus shpërndarjen e informacionit dhe marrjen e problematikave që kanë komunitetet R/E në lidhje me strehimin. 5 përfaqësues të OJF takimi u zhvillua në ambjentet e qendrës multifunksionale.
- Më 10 tetor, pjesëmarrje në aktivitet organizuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Në kuadër të 10 tetorit ditës së shëndetit mendor në ambjentet e Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Mendor, u organizua një aktivitet ku të ftuar kishin nga institucionet e ndryshme që punjnë dhe mbështesin këtë kategori.
- Më 15 tetor, takim me përfaqësuesit e unionit të Egjiptianëve të Shqipërisë, drejtorit të kujdesit social, përfaqësues të minoritetit egjiptjan, specialistin e strehimit për problematikën e restaurimit të banesave të komunitetit R/E.
- Më 17 tetor, takim me përfaqësuesen e zyrës së punës dhe specialistët e saj. Njohja e ligjit, problematikat që hasen dhe mundësia për zgjidhjen e tyre.
- Më 17 tetor Zyra Rajonale ka organizuar trajnim me Qendrën e Formimit Profesional me temë "Diskriminimi fenomen që hasen kudo, format dhe mënyrat për ta zgjidhur atë" pjesëmarrës kursantë, instruktorë.
- Më 22 tetor Pjesëmarrje në aktivitetin me temë "Së bashku në luftën kundër kancerit të gjirit", organizuar nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë.

Nëntor

- Më 4 nëntor, takim me përfaqësuesen e zyrës së mardhënieve me deputetin e rajonit Korçë. Takimi kishte në fokus problematikat e qytetarëve, mundësinë e bashkëpunimit zgjidhjen e tyre.
- Më 5 nëntor organizimi i ditës së hapur me banorët e ish artistikes informim për ekzistencën e zyrës. Problematikat sociale të tyre në lidhje me strehimin, legalizimi i banesave.
- Më 6 nëntor takim me një grup studentesh. Tema: “Gjetja e problematikave nga vetë studentet dhe referimi i tyre pranë zyrës së KMD Korçë”.
- Më 14 nëntor. Specialisti i zyrës Rajonale Korçë në bashkëpunim me A.P organizojnë ditën e hapur me grupet dhe individë në nevojë.
- Më 18 dhe 19 nëntor, pjesëmarrje në trajnim organizuar nga Qendra “Streha” me mbështetjen e Ambasadës Amerikane. Puna me grupet e marginalizuara në tërësi dhe me një fokus të vecantë të komuniteti LGBT.
- Më 20 nëntor. Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Korçë në kuadër të 30 vjetorit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.
- Më 25 nëntor Zyra në bashkëpunim me shoqatën e prindërve të femijëve me AK organizon takimin me rrjetin në mbështetje të personave me AK. Takimi kishte në fokus informimin e rrjetit mbi dy shkresa që janë dërguar Këshillit Bashkiak Korçë dhe Komisionit për çështje sociale dhe shëndetin Tiranë.
- Më 25 nëntor takim me ERRC (Qendra Europiane për të drejtat e Romëve Budapest) OJF R/E Korçë: Tema: Segregimin e shkollës Naim Frashëri, monitorimin e situatës dhe masat që janë marë nga shteti shqiptar, si dhe çështjet e diskriminimit që prekin këtë minoritet rast që është ndjekur nga KMD.
- Më 26 nëntor, pjesëmarrje në aktivitet organizuar nga shoqata “Unë gruaja” me mbështetjen e EU dhe TDH. Tema e këtij aktiviteti “Duajini Fëmijë. Në vend të ndëshkimit zgjidhni edukimin dhe ndërmjetësimin”.
- Më 27 nëntor, pjesëmarrës në grupin e dialogut social ngritur pranë Bashkisë Korçë.

Dhjetor

- Më 3 dhjetor në kuadrin e ditës së personave me AK Zyra Rajonale në bashkëpunim me shoqatën MEDPAK, u organizua një aktivitet i cili kishte në fokus mbështetjen dhe integrimin e kësaj kategorie.
- Më 10 dhjetor 2019, Zyra Rajonale në bashkëpunim me Specialisten e Zyrës së Dhunës pranë Bashkisë Korçë, në kuadër të ditës së të drejtave të njeriut organizuan një takim me gra të dhunuara.

- Më 11 dhjetor 2019 organizim i një dite të hapur me studentët e Universitetit F.S.Noli. me temë: “Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe promovimi i barazisë, si dhe roli i KMD për të ndrequr situata diskriminuese”.
- Më 11 dhjetor, pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Bashkia Korçë me mbështetjen e Këshillit të Europës. Prezantimin e planit të veprimit hartuar nga Bashkia Korçë për minoritetet romë dhe egjiptiane, në kuadër projektit ROMACTED, mbështetur nga KE.
- Më 12 dhjetor, pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Bashkia Pogradec me mbështetjen e Këshillit të Europës. Nga ana e specialistit të Zyrës së Rajonale të KMD Korçë, u bë prezantimi i situatës së banorëve të ish Gurit të Kuq dhe Kabashit të cilët jetojnë në kushte të vështira strehimi dhe ekonomike. Vetë përfaqësuesit e institucionit të prefektit dhe bashkisë ishin të njohur me situatën dhe kërkonin ndërhyrje të menjëhershme, por problematika qendron tek mungesa e një VKM për kalimin e pronësisë së dy objekteve nga institucion prefekturë tek Bashkia.
- Më 18 dhjetor, takim i specialistit të zyrës rajonale me Drejtorinë Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Takimi kishte në fokus ngritjen e problematikës nga ana e qytetarëve për përfitimin e paaftësisë sociale. Ndryshimi i këtij ligji dhe kategoritë që përfitojnë nga ky ligj.
- Më 18 dhjetor, takim me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale dhe Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Takimi kishte në fokus ngritjen e problematikës nga ana e qytetarëve për përfitimin e paaftësisë sociale. Ndryshimi i këtij ligji dhe kategoritë që përfitojnë nga ky ligj.
- Më 19 dhjetor, takim me specialistin e zyrës së punësimit për vështirësitë e qytetarëve për t'u pajisur me kartën e punëkërkuarit. Mungesa e ID tani e në vazhdim e cila penalizon qytetarët për të aplikuar si punëkërkuar si dhe për ndihmën ekonomike.
- Më 19 dhjetor, takim me drejtorin e drejtorisë së kujdesit social dhe atë të Entit të Banesave. Fokusi i takimit. Problematika e strehimit dhe mënyra e mundshme për zgjidhjen e rasteve të tri familjeve të ish konvikti i shkollës bujqësore.
- Më 26 dhjetor, organizimi i trajnimit me përfaqësues të rrjetit të MEDPAK, me temë “Njohja e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Gjatë vitit 2019 janë kryer takime institucionale me Kryetaren e Këshillit të Qarkut Korçë, me Prefektin, me Kryetarin dhe nën/kryetarët e Bashkisë, Zyrën e punës, Drejtorinë e Shërbimit Social, Specialistë të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorinë e Kujdesit Social, Drejtorinë e Shëndetit, Publik, DAR, Drejtorinë Mbështetëse të Arsimit, Kopshteve dhe Çerdheve, Drejtore të shkollave 9 vjecare dhe ato të mesme, ku me ta është bërë e mundur organizimi orëve të lira në të cilat është folur për ligjin dhe Zyrë Rajonale në Korçë.

Dalje në media

Zyra Rajonale Korçë e shikon bashkëpunimin me median si një mjet i rëndësishëm në përçimin e informacionit dhe promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të parandotuar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në këtë kuader ka realizuar këto dalje në median lokale:

- Më janar 2019 dalje ne TV Korça. “Puna e zyrës rajonale e vitit 2018, rastet e parqitura pranë saj, ecuria e tyre.
- Më 17 shkurt Tv Korça. Aktivitet ndërgjegjësuere të zhvilluara në shkollat 9 vjecare të qytetit.
- Më 8 mars. Emisioni i Mëngjesit TV Korça. Të qenurit grua. Sfidat e hasura në jetë dhe puna si specialist e KMD.
- Më 8 Prill.Tv Lobi, në ditën ndërkombëtare të romëve. Mbështetja dhe ankesat pranë kësaj zyre për komunitetin rom. Problematikat e ndryshme social-ekonomike.
- Më 23 prill, TV Korça dhe Lobi TV, Ligji për minoritet.
- Më 13 Shtator, TV Lobi. Ecuria e punës së Zyrës Rajonale të KMD gjatë vitit 2019.
- Më 23 Nëntor, Tv Korça. Segregimi i nxënësve të shkollës “Naim Frashëri”.
- Më18 dhjetor 2019 TV Korça. Rezultatet e KMD për 2019.

1.13 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier

Më 19 Shtator 2019 hapet Zyra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fier.

Shtator

- Më 19 shtator, u mbajt ceremonia e hapjes së Zyrës Rajonale të KMD në Fier.Krahas Komisionierit, Dr. Gajda, Prefektit të Qarkut Fier, Baki Bala, në ceremoni mori pjesë dhe zv/Kryetarja e Bashkisë Fier, Enkelejda Peshkëpia.
- Me hapjen e zyrës si pjesë integrale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuesja e kësaj zyre, ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve lokale, në nivel Qarku, Bashkie dhe Prefekturë, për prezantimin e Zyrës, misionin dhe nevojën e bashkëpunimit të ndërsjellë institucional, për zgjidhjen e rasteve dhe përmirësimin e problematikave të ndryshme.
- Më 20 shtator, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Fier, ku u bë prezantimi i zyrës dhe

funksionit të saj, u bisedua për një marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet tyre, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve.

- Më 24 shtator, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim me Koordinatorin e Komunitetit Rom, "Fondacioni në ndihmë të fëmijëve". Në takim u prezantua hapja e Zyrës Rajonale, rëndësia, misioni dhe qëllimi i KMD. U kërkua bashkëpunim në evidentimin e problematikave të këtij komuniteti si dhe referim të rasteve diskriminuese, pranë Zyrës Rajonale Fier.
- Më 25 shtator, takim informues dhe bashkëpunues me Drejtorinë e Shërbimit Social, Bashkia Fier, me Specialistin për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.
- Më 26 shtator, takim informues dhe bashkëpunues me Qendrën Multifunksionale "Horizont", për integrimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), pranë Bashkisë Fier.
- Më 30 shtator, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në aktivitetin me temë: "Panairi i Shëndetit" të realizuar nga Shoqata "VOICE OF ROMA IN ALBANIA", me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe në partneritet me ANTTARC, në ambientin e Ambulancës Drizë.
- Më 30 shtator, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim informues dhe bashkëpunues me "Executive Director Voice of Roma in Albania". Gjatë takimit, u evidentuan problematikat në shkollën "Trifon Prifti", Hamil.

Tetor

- Më 01 tetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në Aktivitetin me temë: "Ballë për ballë me punën e fëmijëve", projekt i implementuar nga Organizata "Partneriteti për Zhvillim Pozitiv", në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit "Fuqizimi i shoqërisë civile për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe dhuna në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Terre des Hommes, Shqipëri, në partneritet me ANTTARC.
- Më 01 tetor, pjesëmarrje në një takim konsultues me ekspertët e Institutit Shqipëtar, për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I), në kuadër të iniciativës me temë: "Monitorimi dhe përmirësimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale në nivel vendor" (Tiranë, Fier, Berat, Pogradec), me mbështetjen e USAID.
- Më 2 tetor, takim informues dhe bashkëpunues me Policinë Fier, me psikologun dhe koordinatoren për të miturit dhe dhunën në familje.
- Më 9 tetor, takim informues dhe bashkëpunues me Qendrën Komunitare Multifunksionale, Levan, Fier.
- Më 10 tetor, pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Fier, nëpërmjet Qendrës Multifunksionale për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve dhe të Rinjve për Personat me Aftësi të Kufizuara "Horizont", me fokus:

“Ndërgjegjësimin, edukimin, nxitjen sociale apo aktivizmin për zbutje të situatës së kategorive në risk”. Në këtë aktivitet morën pjesë aktorët lokalë, mjekë specialistë, psikologë të qendrës spitalore "Nënë Tereza", Nënkyetarja e Bashkisë Fier, Znj.Enkelejda Peshkëpia, Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore.

- Më 11 tetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim për bashkëpunim me koordinatoren e organizates "Amaro-Drom"(Unioni për zhvillim dhe Integrim për Minoritetin Rom në Shqipëri).
- Më 12 tetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim me qytetaren H.B. Qëllimi i takimit ishte analizimi i rastit të saj, asistencë për të plotësuar formularin e ankesës, referuar KMD.
- Më 14 tetor, takim me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Zyrës së Punës Fier, si edhe përgjegjësen e shërbimit social, për bashkëpunimin ndërinstitucional.
- Më 16 tetor, takim informues dhe bashkëpunues me koordinatoren e Qendrës Sociale Murialdo. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i institucionit, prezantimi i ligjit si dhe punës së KMD.
- Më 17 tetor, takim informues dhe bashkëpunues me kryetar i fshatit Drizë, si dhe Paraligjor, mbështetur nga Fondacioni SOROS. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i institucionit, prezantimi i ligjit si dhe punës së KMD.
- Më 23 tetor, takim me Drejtoreshën e Qendrës rinore “Epoka e Re” për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në aktivitete.

Nëntor

- Më 04 nëntor, pjesëmarrëse në aktivitetin me temë: “Bashkë kundër Trafikimit”, organizuar nga Qendra Sociale Murialdo, me mbështetje të Terre des Hommes, Giz Albania, Bashkia Fier. Qëllimi i aktivitetit: Sensibilizim i pjesëmarrësve mbi fenomenin e trafikimit; Forcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes bashkëmoshatarëve; Fuqizimi i të rinjve duke shmangur paragjykimet dhe diskriminimin; Krijimi i hapësirave dhe modeleve pozitive për të rinjtë. Zyra Rajonale Fier, prezantoi rolin dhe funksionin e saj, si edhe disponimin në çdo rast nevojë për referim çeshtjesh diskriminimi, apo çdo informacion tjetër.
- Më 05 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në trajnimin me temë: “Programet e mbështetjes dhe skemat e financimit të Bashkimit Europian”, organizuar nga “Partnerët Shqipëri”, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe mbështetur nga Bashkimi Europian.
- Më 12 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në ëorkshopin e organizuar nga qendra rinore “Epoka e Re” me aktorët lokalë, ku u bënë së bashku të rinj të shkollave të mesme dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të bashkisë Fier, përfaqësues të shkollave të mesme, përfaqësues të qendrës së aktiviteteve kulturore, punonjës social.

- Më 12 nëntor, Komisioneri zhvilloi një tryezë pune me Organizatat e Shoqërisë Civile, të cilat operojnë në qytetet Fier, Vlorë, Lushnje dhe Berat. Në këtë takim u prezantuan misioni dhe detyrat e Zyrës Rajonale Fier dhe të KMD, nxitja e frymës së komunikimit dhe bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile, për një shoqëri të respektimit të lirive dhe të drejtave, pa diskriminim.
- Më 10 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, realizoi takim me qytetarin Th. K, i cili pasi mori informacionin e nevojshëm, referoi ankesën e tij pranë KMD-së.
- Më 18-19 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: "Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve në mbrojtjen e personave LGBTI+ nga dhuna dhe diskriminimi". Ky trajnim u implementua nga projekti "Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve në mbrojtjen e personave LGBTI nga dhuna dhe diskriminimi", në kuadër të Komisionit të Granteve të Vogla për Demokraci dhe i zbatuar nga "Qendra Streha".
- Më 20 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, ka takuar ankuesin L.R lidhur me ankesën e ngritur prej tij tek KMD.
- Më 20 nëntor, takim me Specialistin e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, në drejtorinë e Shërbimit Social, Bashkia Patos dhe adresimin e rasteve pranë Zyrës së KMD në Fier.
- Më 25 nëntor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në aktivitetin me teme: "Mekanizmi Portokalli", organizuar nga Bashkia Patos dhe mbështetur nga PNUD, në kuadër të çeljes "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje".
- Më 25 nëntor, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare për Eleminimin e Dhunës ndaj Grave", në ambjentet e Pastiçeri Sociale "Ke Buono", u realizua një takim, me pjesëmarrjen e shërbimit social, të Bashkisë Fier, qendra rinore "Epoka e Re", vullnetarë dhe aktivistë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe Përfaqësuesi i Zyres Rrajonale Fier.

Dhjetor

- Më 03 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga "Qendra Multifunksionale, Horizont", Bashkia Fier, në kuadër të "Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuar", qëllimi i të cilit ishte promovimi i të drejtave, mirëqënies dhe rritja e ndërgjegjësimit lidhur me situatën e PAK, në të gjitha sferat e shoqërisë dhe aspektet e zhvillimit të jetës politike, sociale, ekonomike dhe kulturore.
- Më 05 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në konferencën përrmbyllëse "Youth Poëer", organizuar nga qendra rinore "Epoka e Re", me mbështetje të "Albania Partners". Në këtë konferencë morën pjesë të rinjë, përfaqësues të institucioneve lokale dhe përfitues nga projektet e zhvilluara, në Bashkinë Fier. Kjo ishte një konferencë përrmbyllëse e veprimtarisë së gjithë

vitit, ku u vlerësua dhe kontributi vullnetar i të rinjve, duke u nxitur më tepër për të ndërmare nisma konkrete si dhe fushata advokuese, për të adresuar nevojat e të rinjve, në Fier.

- Më 06 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në tubimin masiv, nën moton “Mos hesht, dhuna vret”, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve dhe të 16 ditëve të aktivizmit”. Ky aktivitet sensibilizues, gjithëpërfshirës, u organizua nga Bashkia Fier, me një bashkëpunim të ngushtë me qendrën sociale “Murialdo” dhe shkollave të mesme, “Perikli Ikonimi” dhe “Jakov Xoxa”.
- Më 06 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në konkursin me ese, “Një burrë i vërtetë, nuk godet një grua”, e zhvilluar nga drejtoria e shërbimit social, Bashkia Patos, në kuadër të fushatës “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”. Shkollat 9-vjeçare u përfaqësuan me nga 5 nxënës dhe u vlerësuan me certifikatë falenderimi. Ky aktivitet u realizua në zbatim të projektit “Forcimi i Mekanizmit të Referimit të rasteve të dhunës”, i cili mbështetet nga PNUD Shqipëri.
- Më 18 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, mori pjesë në tryezën me temë: “Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane, në Bashkinë Vlorë, 2019-2022”, në kuadër të programit “Romacted”, mbështetur nga Bashkia Vlorë dhe Këshilli i Europës. Në thelb të këtij takimi, ishte prezantimi i “Planit Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane, në këtë Bashki për vitet 2019-2022”. Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, prezantoi rolin e kesaj zyre, funksionin e KMD në tëresi, si i vetmi autoritet përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi, shpjegoi se ku mund të drejtoheshin nëse ndiheshin të diskriminuar dhe se si plotësohej një formular ankese.
- Më 26 dhjetor, Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, ka takuar qytetaren S.S, e cila pasi mori informacionin e nevojshëm, referoi ankesën e saj pranë KMD- së, më 30 dhjetor 2019. Personat të cilët kanë paraqitur raste dhe problematika të ndryshme, të cilat nuk hyjnë në objektin e Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, janë referuar në institucionet përkatëse, apo organizata të ndryshme që ofrojnë asistencën e duhur. Personat të cilët kanë parashtruar ankesat e tyre me objekt “Diskriminimin”, por kanë qenë jashtë afateve të LMD, janë referuar ta ndjekin çështjen në Gjykatë, për arsye të afateve më të gjata.
- Takime të ndryshme me fokus informimin e qytetarëve, të cilët i drejtohen Zyrës Rajonale dhe realizimin e shpërndarjes së materialeve informuese të KMD.

Daljet në Media

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e shikon bashkëpunimin me median si një mjet i rëndësishëm në përcimin e informacionit dhe promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të parandatur gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese,

ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në këtë kuader, ka realizuar këto dalje në median lokale:

Gjatë periudhës Shtator -Dhjetor 2019, daljet në TV e mëposhtme:

- Shator-Ceremonia e hapjes së Zyrës Rajonale Fier, kanë qënë të pranishme 2 mediat lokale, Tv Kombi dhe Tv Apollon.
- Nëntor-Tryezë pune me organizatat e shoqërisë civile, kanë qënë të pranishme 2 mediat lokale, Tv Kombi dhe Tv Apollon.
- Përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Fier, ka zhvilluar takime me Avokatë të ndryshëm, për të bashkëpunuar në referime çeshtjesh diskriminimi, e cila ka rezultuar e sukseshme.
- Zyra Rajonale Fier, gjatë periudhës shtator-dhjetor, ka bërë 5(pesë) ankesa.
- Zyra Rajonale Fier, gjatë periudhës shtator-dhjetor, ka marrë pjesë në 14 aktivitete ndërgjegjëse dhe 2 trajnime.

Aspekte të Shërbimeve

1.14 Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2019

- I. Është miratuar ndryshimi i kategorisë së pagës për pozicionin inspektor në Drejtorinë e Hetimit Administrativ me Vendimin e Kuvendit Nr.57/2019 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20. 05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të vendeve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, me miratimin e këtij ndryshimi kategoria e pagës për pozicionin inspektor nga III-b kalon në kategorinë III-a.
- II. Në përputhje me planin vjetor të pranimi në shërbimin civil janë zhvilluar 8 (tetë) procedura konkurrim për pozicione të lira pune, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, për pozicionet e punës:
 - Drejtor në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit
 - Specialist i Monitorimit dhe Raportimit në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit
 - Specialist i Komunikimit me Mediat në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit
 - Specialist i Pritjes së Ankesave në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.
 - Specialist i pritjes së Ankesave në Zyrën Rajonale Shkodër
 - Specialist i Pritjes së Ankesave në Zyrën Rajonale Korçë.
 - Specialist I Pritjes së Ankesave në Zyrën Rajonale Fier.
 - Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- III. Janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve, si dhe janë dorzuar pranë ILDKPKI- së dektarat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve ligjore.
- IV. Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASPA), Këshilli i Evropës etj.
- V. Në trajnimin e organizuar nga Departamenti i Administratës Publike janë trajtuar tema si:
- Kodi i Proceduarave Administrative
 - Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
 - Prokurimi Publik
 - Planifikimi buxhetor dhe pasqyrat financiare
 - Sistemi i regjistrimit të personelit dhe pagave HRMIS
 - Sistemi online i deklarimit të interesave private të subjekteve të deklarimit.
 - Përafrimi i legjislacionit.
 - Negocimi dhe vendimarrja.
 - Barazia gjinore dhe buxhetimi i përgjithshëm
 - Analiza gjinore dhe integrimi gjinor në administratën publike
 - Monitorimi dhe raportimi i të drejtave të njeriut.
 - Kontroll i brendshëm dhe Auditi.
- VI. Punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira si dhe në aktivitete të ndryshme të organizuarë në fushën e të drejtave të njeriut/diskriminimit me tema:
- Përgatitja për procesin (pre) screening kapitulli 19.
 - Përmirësimi i bazës së të dhënave për çështjen e dhunës në familje, parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës.
 - Integrimi dhe përfshirja e personave me çrregullime të spektrit autik në arsimin gjithëpërfshirës.
 - Prezantimi i Qendrës së Emergjencës për fëmijët viktime të trafikimit.
 - Barazia gjinore, stereotipet e dëmshme dhe dhuna me bazë gjinore.
 - Ecuria e zbatimit të Reformës në Drejtësi: Arritjet dhe sfidat.
 - Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve migrant.

1.15 Menaxhimi i burimeve financiare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në zbatimin të buxhetit të vitit 2019, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore për 6-mujorin e parë, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”, ndryshuar.

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjëve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2019.

Ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej **43.148,65 (në mijë lekë)** për vitin 2019. Totali i vlerës së akorduar duke përfshirë edhe fondin e donatorëve prej **431,48 (në mijë lekë)** përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	28. 500	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4.600	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	9. 400	<i>mijë lekë (zëri 602-606)</i>
Fondi për Investime:	5. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>
Fondi i Donacioneve:	431, 48	<i>mijë lekë (zëri 600,602)</i>

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është 47.931,48 (në mijë lekë), për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore 43.580,13 në mijë lekë ose **90,92 %** e buxhetit total mujor të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore është realizuar nga 33.100 (në mijë lekë) të planifikuar për këtë periudhë, është realizuar 33.039,84 (në mijë lekë) për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **99,82 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime është planifikuar në vlerën 9.400 në mijë lekë dhe është realizuar vlera prej 8.769,01 (në mijë lekë) ose **93,29 %**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej 5.000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, nuk është realizuar vlera e plotë. Nga tre projekte të publikuara, dy janë realizuar plotësisht dhe projekti i tretë “Përshtatje dhe rikonstrukcion I godinës së KMD me element PAK (Persona me Aftësi të Kufizuar)” me vlerë 3.656 (në mijë lekë), nuk është realizuar për shkak të afateve të shkurta që institucioni kishte në dispozicion.

Fondi i Donacioneve për vitin 2019, është në vlerën 431,48 (në mijë lekë) është realizuar në projektin me UNICEF (Nëntor 2018-Janar 2019), vlera prej 431,48 (në mijë lekë) ose **100 %**, e fondit të planifikuar.


Realizimi dhe përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi ka qënë në masën **90,92 %**.

1.16 Veprimtaria e IT

Menaxhimi i portalit web-it dhe Mediave Sociale të KMD

Spektori i IT ka në përgjegjësi administrimin, mirëmbajtjen, përditësimin me informacione nga aktivitetet e organizuar, si dhe lajme me përmbajtje ekonomike të faqes së web-it, dhe Mediave Sociale të KMD.


Në grafikonin e mëposhtëm jepet numëri total i vizitorëve të faqes së KMD për vitin 2019.



Nr. i vizitorëve të faqes web të KMD

Trafiku i gjeneruar ka ardhur nga:


- Trafik nga referimet e jashtme, Social Media 3.2%
- Trafik Direkt për vizitore të rinj të web-it 18.4%



Shpërbërja e vizitorëve të faqes së KMD

Profili Facebook, i cili është gjithmonë e më aktiv vitit 2019 duke arritur një audiencë më të lartë se në vitin 2018.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme është arritja organike si dhe virale e informacionit, e cila ka qënë e sukseshme. Statistikat e faqes së facebook për vizitorët e saj të ndara në kategori, variojnë si më poshtë.



Nr. dhe gjinia e vizitorëve të facebook-ut